

ABDULLAH NASIH ULVAN

LE TA DIJË RINIA

The bottom of the page features a decorative graphic consisting of several overlapping, wavy lines in shades of brown and teal, creating a sense of movement and depth.

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

LE TA DIJË RINIA

Abdullah Nasih Ulvan

Botuar nga: Biblioteka Muhamed Ikbali

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Mr. Zekerija Bajrami

NË VEND TË PARATHËNIES

Lavdi dhe falënderimi i qofshin Allahut xh.sh. i cili krijoi Gjithësinë dhe e caktoi sistemin për mirëvajtjen e saj, kurse lutjet dhe përshëndetjet tona i takojnë të Dërguarit të Tij, Muhammedit s.a.v.s të cilin e zgjodhi për udhëzimin e njerëzimit, që me atë të përfundojë misionin hyjnor, vula e të dërguarve të Perëndisë dhe shpalljeve të Tij.

Sa i përket librit Le ta dijë rinia të autorit Abdullah Nasih Ulvan dhe përkthimit të tij në gjuhën shqipe, në këto kthesa historike të popullit tonë në përgjithësi, e veçanërisht të rinisë sonë, në duar të së cilës gjindet ardhmëria jonë, është më se i nevojshëm edhe atë nga disa aspekte:

1 – Interesimi i përgjithshëm për njohuri të shëndosha dhe informata të sakta lidhur me Islamin, çdo ditë është më i madh, e pa marrë parasysh qëllimin e këtij interesimi; dikush vetëm nga dëshira që të informohet për të, dikush nga fakti se gjindet në udhëkryq të jetës e nuk din se çfarë të zgjedh për sistemin jetësor, e dikush tjetër me qëllim që në bazë të Islamit t'i gjykojë sjelljet e veta dhe praktikimin e jetës se përditshme ta ketë sa më korrekt.

- Ky lloj interesimi për Islamin tani ekziston edhe është në rritje të mbarë shoqëria njerëzore e sidomos te ata të cilët në një mënyrë i takojnë Islamit, siç është populli shqiptar, por verbëria e një sistemi dhe luftimi i tij kundër Islamit dhe çdo parimi të tij e ka bërë të veten.

Pa marrë parasysh se nga cili grup vjen ky interesim, qëllimi i të gjithëve është që të njoftohen me Islamin e pastër dhe origjinal, ngase atë që kanë nga njohuritë për Islamin dhe informatat rreth tij shpeshherë nuk përputhen e ndonjëherë janë edhe në kundërshtim me Islamin e vërtetë, që pastaj mbi këto (mos) njohuri dhe (dez) informata t'i ndërtojnë qëndrimet e gabuara lidhur me Islamin, e gjithë kjo vjen prej asaj se burimi i këtyre (mos) njohurive dhe (dez) informatave janë traditat e ndryshme të shumë mjediseve dhe interpretuesit jokompetent për interpretimin e Islamit.

2 – Fakti që jetojmë në një shoqëri shumënacionale dhe shumëkonfesionale, të përzier në aspektin kombëtar dhe fetar, me një sasi rrezeve bukur të madhe ndaj njëri-tjetrit, nga mosnjohja në mes veti në përgjithësi, e veçanërisht në aspektin fetar, njohuritë e shëndosha mbi Islamin dhe informatat ekzakte për të janë më së të nevojshme, sepse vetëm në bazë të njohurive dhe informatave të shëndosha besimtari musliman mund të lejojë të afrohet si dhe të ofrojë aq sa duhet dhe sa mundet dikënd

me përkatësi fetare tjetër, gjithashtu ana tjetër, vetëm mbi njohuritë dhe informatat e shëndosha dhe të sakta për dhe rreth Islamit, mund t'i afrohet dhe ta ofrojë besimtarin në përkatësi fetare Islame dhe kështu sasia e “rezervës” dhe “ftohjes” në mes njëri-tjetrit zhduket ose zbutet deri në minimum.

3 – Zbulimet e ndryshme që u bënë dhe tani bëhen si dhe zhvillimi i teknologjisë, bënë që njeriu të jetojë në një jetë më të lehtë, por këto zbulime dhe zhvillime nuk ia rritën njeriut qetësinë dhe sigurinë e tij, përkundrazi e shqetësuan krejtësisht dhe e luhatën sigurinë e tij në themel. Civilizimi modern ia ka përsosur dhe zhvilluar njeriut tërë atë që ka pranë vetes por vetë njeriun e ka lënë atje ku ka qenë në kohërat e lashta në lidhje me sjelljen, respektimin ndaj njëri-tjetrit. Nëse numërojmë çka i ka bërë njeriu njeriut në shekullin tonë, nga armiqësitë ndaj jetës së njeriut, pasurisë, nderit dhe autoritetit të tij si dhe të drejtave të tija elementare, pa marrë parasysh a vjen dhuna dhe terrori nga një individ, grup, racë apo shtet, së shpejti do të bindeshim se në këtë aspekt ua kemi tejkaluar shekujve të mesjetës.

Ngritjen e moralit nuk mund ta bën asgjë tjetër pos feve të shpallura nga Zoti, e sa u përket ideologjive të cilat janë fryt i mendjes së njeriut, bota e provoi komunizmin i cili atje ku u aprovua, jo që shkatërroi ekonominë por shkatërroi edhe moralin, dhe degradoi personalitetin e njeriut në përgjithësi, dhe më në fund ky sistem pësoi disfatë totale. Fatin e komunizmit do ta përjetojnë të gjitha ato ideologji që i shpiku mendja e njeriut, me qëllim që në një mënyrë të stolisë veten për perëndi, duke e larguar Zotin e vërtet nga kokat e njerëzve dhe shpirtërat e tyre.

Është koha e fundit që t'ju lirohet vendi feve tjera që në konkurrencë mes veti, për dobitë morale, materiale dhe shpirtërore për njeriun, të provojmë fatin e tyre, me qëllim që ta shpejtojnë njeriun, ose së paku t'ia lehtësojnë, gjithë atë që e brengos dhe e shqetëson duke ia ruajtur të arriturat e tij mendore, shkencore dhe shoqërore.

Në fund duke e lutur Allahu xh.sh. për mëshirën e Tij ndaj të gjithëve, ndaj atyre që e ndajnë vetën se janë në rrugë të Zotit, nëse janë, t'i përqëndroje; ata që janë të larguar rrugës së Tij t'i udhëzojë, të rinjë të mbrojë, të moshuarit t'i shpëtojë.

Të gjithëve ju porosis:

Rinia jonë ashtu siç është sot, është “krenaria ose turpi ynë”. Rinia jonë ashtu si do të jetë nesër; do të jetë fati ose fatkeqësia jonë.

Siq ishin të vjetrit deri dje për ne, ne sot ashtu jemi për të rinjt tanë. E si jemi ne për të rinjt tanë sot, ata nesër do të bahen për nipat tanë. E tërë kjo është ligj i Zotit xh.sh. i cili askënd nuk e veçon e as mëshiron, por besimtarët pa aspak dyshimi i udhëzon kur thotë: “Edhe ata që erdhën pas tyre (të parëve) thonë: Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona fare urrejtje ndaj atyre që besuan (me vonë). Zoti ynë Ti je i Butë, Mëshirues!¹.

Ja kështu, sipas qëndrimeve të Kur’anit, brezi aktual lidhet me brezin e vjetër i cili e ka bërë të veten nga njëra anë dhe me brezin e ri i cili pas një kohe nxen vendin meritues e kështu me radhë radhitet zinxhiri i ummetit të Muhammedit a.s., e para hallkë e zinxhirit është vetë i Dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s., kurse hallka e fundit e zinxhirit është ithtari i fundit i fesë Islame.

All-llahu mos të na largojë nga mëshira e Tij. Amin.

Shkup, 30.09.1992

Sabahuddin Mahmuti

¹ Kur’ani: Hashr, 10

RINI, A E DINI PËR Ç'JENI KRIJUAR?

Bismil-lahir-rahmanir-rahim

...Me emrin e All-llahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotit. Rini Islame!

U lavdërojë juve tek All-llahu xh.sh. përveç të cilit Zot tjetër nuk ka: Lus All-llahun që të falë Muhammedin a.s. dhe njëkohësisht e përshëndes atë, të parin e muxhahidinëve, përshëndes familjen e tij, as'habët dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit

* * *

Rini, a e dini për çka jeni krijuar dhe çfarë janë obligimet tuaja? Jeni krijuar që të vërtetoni qëllimin e bërjes së ibadetit All-llahut xh.sh., përkuljes ndaj Tij, nënshtrimit të plotë ndaj Madhërisë së Tij. Për këtë All-llahu xh.sh. thotë :

“Unë nuk krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë”². Jeni krijuar për t’ju përmbajtur ligjit të All-llahut xh.sh. të cilit nuk i mvishet e pavërteta nga asnjë anë por ky ligj është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit...

“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të dëshpëruarve”³.

Jeni krijuar t’i besoni dhe ta nderoni All-llahun xh.sh., Pejgamberin s.av.s. dhe besimtarët.

“Mbrotësi juaj është Allahu, Profeti i Tij dhe besimtarët të cilët me përlulje kryejnë faljen, japin zekatin dhe janë të përlulur. Kush e merr për mbrotës Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, ta dijë se ata që janë me Allahun janë ngadhënjimtarë”⁴

Përgjegjësia juaj më e madhe, me të cilën u ka obliguar All-llahu xh.sh. dhe vetëm për atë u ka krijuar, është mbisundimi i ligjit të All-llahut xh.sh. në sipërfaqen e tokës dhe largimi i njerëzve prej adhurimit të krijesave, të orientimit kah adhurimi i Tij (Allahut), dhe largimi prej ngushticës së kësaj bote kah gjerësia e saj, largimi prej padrejtësive të sistemeve tjera dhe të drejtuarit kah objektiviteti i Islamit.

² Kur’ani: Dharijat, 56

³ Kur’ani: Ali Imran, 85

⁴ Kur’ani: Maide, 55-56

A e dini rini me çka realizohet ky qëllim?

Realizohet me anë të pesë cilësive qenësore në të cilat duhet të jeni të vendosur dhe të përgatitur që t'i përforconi (në vete):

Me besim të thellë e të paluhatshtëm:

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut dhe të Dërguarit të Tij, mandej nuk dyshuan dhe për hirë të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillët janë ata të vërtetët”⁵

Me sinqeritet i cili nuk pranon dyfytërsi – dinakëri...

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhurojnë Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, ta japin zekatin se ajo është feja e drejtë”⁶

Me këmbëngulje e cila nuk pranon frikë...

“(Ligji i Allahut ndër) Ata, të cilët i kumtojnë shpalljet e Allahut, i frikësohen vetë, Allahut e askujt tjetër përveç Tij”⁷

Me punë permanente e cila nuk ndjen lodhje e as mërzë...

“Dhe thuaj: Veproni. All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t’ju njoftojë për atë që vepruat”⁸

Me sakrificim dhe flijim të shtrenjtë i cili nuk pranon asgjë përpos fitorës apo rënies shehid...

“Po ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u provuar edhe ju më shembullin e atyre që ishin para jush. Të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i

⁵ Kur’ani: Huxhuratë, 15

⁶ Kur’ani: Bejjine, 5

⁷ Kur’ani: Ahzab, 39

⁸ Kur’ani: Tewbe, 105

dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar, Kur do të jetë ndihma e Allahut?! Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e Allahut është afër!”⁹

Me të vërtetë këto janë cilësi të atyre që zbatojnë premtimin që ia kanë dhënë Allahut xh.sh. dhe nga veçoritë e rinisë e këta duke i qenë besnik rrugës së Allahut nuk u frikohen fyerjeve dhe nënçmimieve të askuj, sepse themel (bazë) i besimit është zemra e pastër, themel i vendosshmërisë janë ndjenja dhe ndërgjegjja e forte, themel i punës është dëshira e flaktë, themel i flijimit dhe sakrifikimit është besimi i thellë. Këto cilësi duhen të gjenden tek rinia dhe janë veçori e të rinjve besimtarë. Pra këtu, nënkuptojmë se, rinia në të kaluarën dhe në çdo periudhë kanë qenë dhe janë faktor i përparimit apo i rënies së popullit, fuqisë, autoritetit, bartës i flamurit të popullit, dhe udhëheqës i masës kah fama dhe fitorja.

“Ne po të rrëfejmë saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmosha kishin besuar Zotin e tyre, e Ne atyre edhe më ua shtuam bindjen”¹⁰

⁹ Kur’ani: Bekare, 214

¹⁰ Kur’ani: Kehf, 13

GRUPI I PARE I BESIMTARËVE ISHIN RINIA

Rini! Duhet ta dini se grupi i besimtarëve i cili u vendos në shtëpinë e Erkamit dhe po ata që shënuan (realizuan) fitoren e Islamit ishin rinia. Muhammedi a.s. kur filloi t'i arrijë shpallja ishte në moshën 40 vjeçare, Ebu Bekri ishte 37 vjeçar, Omeri ishte 27 vjeçar, Othmani ishte më i ri se Pejgamberi, e Aliu ishte me i ri se të gjithë, poashtu Abdullah ibën Mesudi, Abdurrahman ibn Aufi, Erkam ibn ebi-Erkam, Seid bin Zejdi, Musab ibn Umejr, Bisal ibn Rabbah, Ammar ibn Jasir dhe qindra të tjerë. Të gjithë këta ishin të rinjë. Këta ishin ata të cilët e bartën mbi supet e veta përgjegjësinë e thirrjes (dawes) në Islam; Këta janë ata të cilët kanë qenë të ndëshkuar për hire të nderit të Islamit, kanë treguar durim të singertë ndaj torturave dhe nuk e kanë kursyer veten... ata janë ata të cilët e kanë bashkuar natën me ditën, derisa kanë realizuar përhapjen, fuqinë dhe mbisundimin e pushtetit Islam. Për një kohë të shkurtë mbizotroi shteti Islam, u formua udhëheqësia dhe qeveria e tij dhe për një kohë të shkurtër këtij shteti iu nënshtrua Persia dhe Bizanti. Pushteti i tij u zgjërua prej Sindit në Lindje deri në qytetin e Hizrit dhe Ermenisë në Rusi në Veri. Drejtësinë e tyre (muslimanëve) e pranuan Shami, Egjipti, Breka, Tripoli, dhe qytetet e tjera të Afrikës... gjithë kjo ndodhi brenda disa viteve. Gjatë sundimit të Emevive sundimi dhe fuqia e tyre u zgjërua aq shumë sa që shumica e tokave të Indisë dhe Turkistanit ranë nën sundimin e tyre, muslimanët arritën deri në kufinj të Kinës në Lindje, hynë në qytetet e Endelusit (Spanjës së sotme) në Evropën perëndimore.

Halifi musliman Harun Er-Rashid për t'ia bërë të ditur botës se sa sipërfaqe përfshin pushteti Islam, u desht që reve, të cilat kalonin mbi të t'u thoshte:

“Bartni shiun kah të doni se prap do të bini në tokat tona.”

Poashtu Ukbe ibn Naif u ndal në brigjet perëndimore të Oqeanit Atlantik dhe kur kali i tij shkeli buzë detit tha: “O Zot sikur të mos ishte deti do ta çliroja botën për hirë të ngritjes dhe mbisundimit të fjalës Tënde, O Zot pra dëshmo!!!”

Kutejbe el-Bahiliu arriti në skaj të Lindjes dhe e pa të domosdoshme të hyjë në qytetet e Kinës, njëri prej shokëve të tij duke ia tërhequr vërejtjen me urtësi tha: “Depërtove në tokat Turke o Kutejbe, koha nuk të garanton çdoherë fitore”. Kutebeja i bindur thellësisht dhe me një besim të plotë që kishte ndaj Zotit iu përgjigj: “Me besimin e thellë që kam ndaj Zotit depërtova, kur të kalojë koha (kur të bëhet vonë) nuk do të ndihmojë forca (përgatitja)”. Shoku i tij i cili ia tërhoqi vërejtjen kur e pa vendosmërinë dhe guximin e tij për vazhdimin e luftës për ngritjen e fjalës së All-llahut xh.sh. i tha atij

(Kutebejes): “Vazhdoje rrugën, luftën kah të duash o Kutejbe, kjo është vendosshmëti, të cilën vetëm All-llahu e dhuron!!!”

Mendimtari Islam Muhammed Ikbal (All-llahu e mëshiroftë) ka shkruar: Në faltoret e Francës dëgjohej ezani ynë, Jehonë e cila para aradhave çlironte qytete. Nuk harrohet Afrika me zhavor të zi, Sexhdet tona, kur toka villte zjarrë!

Kur para shpatave hapnim gjoksat tanë, Nuk frikësoheshim nga mizorët tiranë. Hija e shpatës si kopsht i gjelbëruar, Na dukeshite si lule e lulëzuar.

Ejani me mua rini t’i pyesim tokat e Shamit, popullin e Irakut, kopshtet e Endelusit, luginat e Egjiptit, shkretëtirat e gadishullit Arabik, gjërësitat e Afrikës dhe vendeve tjera të huaja, tokat e Indisë, hapësirat e Kinës, majet e maleve që t’ju lajmërojnë për ushtarët guximtarë dhe krenarë të cilët u edukuan ne frymën e besimit Islam, të cilët janë shkolluar në xhamitë e Medinës, Mekes, Aksasë, Kordovës, Ez’herit, në xhaminë e Emevive... Të gjithë ata posedonin krenari, dituri dhe trimëri ishin njerëz të vlefshëm, njerëz me ideale të larta dhe sakrifikues. Ata ishin persona me zemra dhe shpirtëra të pastër, përhapën dituritë, nderuan qenien njerëzore, zhdukën gjurmët e idhujtarisë dhe ishin pishtarë të së vërtetës, udhëzimit dhe njohurive... sikur prej toke buronte vetëm mirësi, mjalte dhe qumësht, i vulosën në ndërgjegjen e kohës parimet e besimit, drejtësisë, vëllazërisë dhe barazisë.

A ka parë bota njerëz më të zgjuar, më të urtë, më të ndershëm, më të mëshirshëm dhe më të dijshtëm se ata? – E shpallën lirinë po në ato kohëra, kur popujt e botës ishin të lidhur me prangat e robërisë, e përhapen besimin në të vetmin Zot, kur injoranca kishte robëruar trurin e njerëzve, vendosën drejtësinë kur Persia dhe Bizanti nënshtronin popujt tjerë për qëllimet e tyre okupuese.

– Harxhuan pasurinë e tyre për qëllime fisnike po në atë kohë, kur të tjerët grumbullonin pasurinë në mënyrë jonjerëzore, mbronin nderin familjar po në atë kohë kur të tjerët shitnin nënat dhe motrat e veta. Të përkulur ndaj Allahut xh.sh., krenar ndaj tjerëve me zemër e donin mirësinë, u iknin veprave të këqija, shpirtërisht i besonin të vërtetës, e mohonin çdo të pavërtetë, mbanin lidhshmëri të ngushtë me Zotin dhe me njerëzit. Me besimin Islam u ngritën para botës. Punonin në këtë botë për t’i shërbyer fesë, e bashkuan fenë dhe jetën e kësaj bote që të jenë në jetën e tyre krenarë, kurse në botën tjetër të shpëtuar. Sunduan botën dhe i siguruan asaj paqe, kur i kaplonin vështirësitë i pranonin me durim dhe buzëqeshje, ndërsa sulmuesve të tyre ua humbnin gjurmët. Gjaku i dëshmorëve (shehidëve) kishte aromë të rinisë dhe

të rriturve, shigjeta e armikut në gjoksin e tyre ishte gradë (nderi) e krenarisë, vrapi i tyre në rrugën e All-llahut xh.sh. ishte si kënga e grave dhe fëmijëve. Aradhat e dëshmorëve ishin krushqit e tyre, tingëllima e shpatave ishte muzika dhe ritmi i tyre. Nënat qysh prej vegjëlisë i përgatitnin fëmijët e tyre për luftë në rrugën e All-llahut xh.sh. Ata në realitet ishin brez i dalluar, jo si brezat tjerë, ishin burra të pashoq, popull udhëheqës, jo si popujt tjerë. Këta janë paraardhësit e mi e sot vështirë është të gjesh njerëz të atillë.

PESË MOTOT QË E PËRCJELLIN NJË BESIMTAR

Motot, të cilat dëgjohen shpesh nga gojat e besimtarëve në shumë vende, nuk mund të ndikojnë në zemrën e besimtarit dhe nuk mund të nguliten në shpirtin e tij nëse brohoritësi nuk i ndjek me vepra nxënësit e Medresesë së parë që e themeloi i Dërguari i All-llahut Muhammedi s.a.v.s., halifët dhe sahabët e tij dhe ata të cilët me sinqeritet e ndoqën rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Në këtë medrese diplomuan burra, trima të cilët ishin dhe do të jenë pasqyrë e brezave të ardhshëm muslimanë për çdo kohë dhe vend; pishtarë të besimit dhe sinqeritetit, xhihadit, flijimit, burimit dhe vendosshmërisë, pishtarë të komunikimit dhe thirrjes në Islam, pishtarë të sjelljeve të mira dhe moralit shembullor.

Kur rinia do t'i zbatojë dhe përvetësojë këto pesë cilësi dhe do të shihet gjurma e tyre në fjalët dhe veprat e vet saj, atëherë shpresohet se Islami paraqet fuqi dhe prosperitet, muslimanët do të fitojnë bashkimin dhe pushtetin... Ky është premtimi i All-llahut xh.sh. për ne.

ALL-LLAHU (FEJA E TIJ) ËSHTË QËLLIMI YNË

A e dini rini se çdo të thotë motoja “All-llahu (feja e tij) është qëllimi ynë”?

- Të jeni të sinqertë ndaj All-llahut xh.sh. në çdo fjalë dhe vepër, në çdo ibadet dhe mund (kontribut) derisa All-llahu xh.sh. t'ju shënojë në regjistrin e të sinqertëve. Dhe le të jetë kjo moto të cilën e përsëritni në shumë raste në përputhshmëri me ajetin e Kur'anit: “Thuaj: Namazi im, kurbandi im, jeta dhe vdekja ime, janë thjeshtë për All-llahun xh.sh., Zotin e botërave, Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër, me këtë thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin), jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (që pranoj dhe i bindem) !”¹¹

- Të besoni nga brendia e zemrës suaj se vetëm Islami është udhërrëfyes, shpëtimtar dhe i përhershëm, përpos tij të gjitha sistemet, ligjet dhe ideologjitë tjera janë humbje e kohës, regres, ndëshkim dhe injorancë.

Për këtë më së miri e dëshmon ajeti kur'anor: “Ta zbritëm që edhe ti të gjykosh në atë që të zbriti All-llahu e mos ndiq dëshirat e tyre dhe rrezikut të tyre që mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu xh.sh. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd), ti dije se All-llahu ka për qëllim t'i ndëshkoi ata për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë një

¹¹ Kur'ani: En'am, 163

shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës. A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se ai i All-llahut.”¹² Plotësishtë t’u dorëzohemi urdhërave të All-llahut xh.sh. dhe t’u ikni ndalesave të Tij. Kjo është prej simptomeve të besimit dhe adhurimit ndaj All-llahut të Lartëmadhëruar, për atë se Ai është Krijues dhe Atij i takon që t’i obligojë njerëzit me atë që që do Ai. Ai është më i dijsëm se çdo sistem, program dhe normë që është i dobishëm për ata (njerëzit), Ai është i Urtë e aty ku don vendos atë që duhet. Ai është më i dijsmi pasiqë din të ofron dobinë dhe të largon të keqen, të dëmshmen.

Do të mjaftonte për ju ta keni model dhe parysh dorëzimin e Omerit r.a. praktikës së Pejgamberit a.s. në të puthurit e Haxherul-Esvedit duke mos ditur qëllimin e këtij gjesti, prandaj iu drejtua gurit duke i thënë: “Dije o gurë se ti je vetëm gurë, nuk mund të bësh as dëm e as dobi dhe unë sikur mos ta shihja Resulullahun s.a.v.s. duke të puthur nuk do të kisha bërë këtë gjest”.¹³ Zoti xh.sh. i cili pa dyshim shpreh vetëm të vërtetën në suren Ahzab, ajeti 36, thotë: “Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe besimtareje që në atë çështje të tyre të bëjnë ndonjë zgjedhje tjetërfare”.

Të jenë të bindur nga thellësia e zemrës se të ngjallurit dhe të vdekurit e dikujt është punë e All-llahut xh.sh. Ai ngren lartë dhe poshtë kë të don, Ai është i dobishëm dhe sprovues, jep pa masë dhe kufizon, në dorë të Tij janë sjelljet e çdokujt dhe mbi çdo gjë është Mbizotërues.

S’ka rrugëdalje tjetër përpos dorëzimit në përcaktimin e All-llahut xh.sh. në çdo gëzim dhe pikëllim, pajtimit me përcaktimet e Tija në çdo ndodhi, të duroni në gjykimet e Tij në çdo provim dhe fatkeqësi. Mjafton të keni parasyshë fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti përgëzoi durimtarët, të cilët kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi !” Të tillët janë që Zoti i tyre kanë bekime dhe mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë”¹⁴.

Dhe si përfundim, nuk mund ta vërtetoni sinqerisht moton tuaj “All-llahu (feja e Tij) është qëllimi ynë”, përveç nëse kënaqësinë e All-llahut xh.sh. dhe frikën ndaj Tij ta keni

¹² Kur’ani: Maide, 49-50

¹³ Transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi

¹⁴ Kur’ani: Bekare, 155-157

qëllim final në shpirtërat tuaj, duke marrë parasysh ajetin e Kur'anit: "... e më e drejtë është që ata t'a bëjnë të kënaqur All-llahun dhe të Dërguarin e Tij (me adhurim dhe vepra të singerta) nëse vërtetë janë besimtarë"¹⁵... dhe fjalën e Pejgamberit a.s. ku ai thotë:

"Kush e hidhëron All-llahun për t'ua plotësuar dëshirën njerëzve, atë All-llahu e len në dorë të njerëzve, kush i hidhëron njerëzit për atë që kërkon All-llahu, All-llahu i mjafton të njëjtit"¹⁶.

"Kush e hidhëron All-llahun për t'ia plotësuar dëshirën sulltanit (sunduesit) ka dalë prej fesë së All-llahut xh.sh."¹⁷

Sa bukur do të ishte sikur të ndiqnit fjalët e autorit të këtyre vargjeve në të cilat ai shpreh dashurinë ndaj All-llahut xh.sh. :

O Zot, po sikur me ty të jem mirë, Jata le të jetë e hidhur.

Dhe sikur Ti të pajtohesh Bota le të hidhërohet

Dhe sikur me Ty të kem marrëdhënie të përsosura Marrëdhëniet e mia me botën le të jenë të Shkatërruara.

Nëse meritoj dashurinë Tënde Gjithçka është në rregull,

Sepse gjithë ajo që është mbi tokë është (vetëm) Tokë.

PEJGAMBERI ËSHTË SHEMBËLLTYRA DHE UDHËZUESI YNË

Pastaj a e dini rini ç'është qëllimi i motos: "Pejgamberi është shembëlltyra dhe udhëzuesi ynë"?

Domethënia e saj është ndjekja e plotë e shembëlltyrës së tij të lartë që i ka tejkaluar të gjitha mençuritë dhe pjekuritë njerëzore. Ai ka qenë dhe do të mbetet më tutje kandil ndriçues në brendësinë e errësirave dhe shtigjeve të injorancës... Në çdo periudhë kohore njerëzit gjejnë dhe do të gjejnë në personalitetin e Muhammedit a.s. shembëlltyrën e lartë dhe udhërrëfyesin me vlerë, kandilin që gjithëmonë ndriçon.

¹⁵ Kur'anit: Tewbe, 62

¹⁶ Transmeton: Tirmidhiu

¹⁷ Transmeton: Hakimi

“Më së miri All-llahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e vet”.¹⁸

Shembëlltyra karakteristike e të të zgjedhurit (Muhammedit a.s.) për këtë mision të përhershëm dhe të shkëlqyer, (paqa dhe mëshira e All-llahut xh.sh. qofshin mbi të) ka përfshirë çdo fushë, qoftë ajo e ibadetit dhe devotshmërisë, modestisë, urtësisë, guximit, trimërisë, të komunikuarit modest me të tjerët por poashtu edhe vendosshmërisë ndaj parimeve Islame. Urdhëroni rini që etjes sonë shpirtërore t’i ofrojmë një pikë ujë nga thellësia e detit moral të tij dhe me të të pastrohen mbeturinat e injorancës dhe, të bëhemi reflektorë në mesin e njerëzve.

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË IBADET

Urdhëroni që të ndjekim shembëlltyrën e devotshmërisë e cila ka arritur gradën më të lartë nëpërmjet të ibadetit ndaj All-llahut xh.sh., për të cilin Mugire ibën Shu’be thotë: “Pejgamberi a.s. bënte ibadet natën derisa edhe këmbët i enjtëshin dhe kur për të iu parashtrua pyetja se pse ai vepron kështu pasi që All-llahu ia ka falur mëkatet e mëparshme dhe të mëvonshme, ai tha: A mos të jem rob (krijesë) i Tij (All-llahut) falendërues?”¹⁹

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë prej Alkames i cili ka thënë: “E pyeta Aishen r.a.: A ka veçuar Pejgamberi a.s. ndonjë kohë për ibadet (adhurim)? Ajo tha: Jo, vazhdimisht është lutur, por kush prej jush mund ta kalojë (kohën) në ibadet sikur ai?” Po në këtë mënyrë ka qenë lidhshmëria e tij me All-llahun për çdo herë. Gjatë ibadetit dhe lutjes ndjente kënaqësi të thellë. Pos asaj që rrinte në këmbë natën, edhe gjatë ditës veçonte një kohë të posaçme për ibadet (pos kohëve të namazit). Në namaz gjente kënaqësinë më të madhe shpirtërore, por në disa raste pushonte që t’ua bëjë me dije shokëve të tij se po ky ibadet i natës nuk është obligim për secilin, po mund ta kryen secili sipas mundësive.

Enesi r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka agjëruar pos ditës edhe natën (pa ndërprerë ditën dhe natën). Kjo ishte kah fundi i muajit të Ramazanit; kështu vepruan edhe disa besimtarë të tjerë, për këtë gjë u lajmërua Muhammedi a.s. dhe ai për këtë tha: “Sikur të vazhdonte ky muaj, do të agjëronim pa ndërprerë derisa të dorëzoheshin ata që kanë agjëruar në këtë mënyrë, iu drejtua atyre dhe tha: “Unë nuk jam sikur ju,

¹⁸ Kur’ani: En’am 124

¹⁹ Transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi

mos më ndiqni në këtë (në agjërim pa ndërprerë), se mua më jep fuqi All-llahu e ju agjëroni ditën e jo edhe natën!”

Le ta marrim shembull ibadetin të Muhammedi a.s. i cili ka arritur gradën më të lartë duke mos lënë anash aktivitetin e jetës së përditshme, siç ishte thirrja në Islam, lufta në rrugën e All-llahut xh.sh., i printe popullit në përgjithësi, vuri themelin e shtetit Islam në sipërfaqen e tokës, u dërgonte delegacione udhëheqsëve, mbretërve të botës për t'i thirrur në Islam, poashtu pranonte delegacione të jashtme, dërgonte ushtrinë dhe në shumë raste edhe vetë i printe, kontaktonte me ithtarët e feve të ndryshme si dhe me sundimtarë të ndryshëm, u përgatiste dhe u jepte njerëzve peshqesh për fitore, i dërgonte nëpunësit, i mbikqyrte të ardhurat e shtetit, vetë i shpërndante dhe thoshte: “Nëse unë nuk veproj drejt po kush do të veprojë?” U shpjegonte njerëzve fenë e All-llahut xh.sh., më qartë ua sqaronte çështjet e fesë, ua trasonte traditën Islame, ua shpjegonte gjërat më të imëta të fesë, i largonte nga ajo që nuk është porosi e All-llahut dhe i drejtonte kah porosia e Tij. Pas gjithë kësaj i kryente edhe punët e përditshme familjare për të cilat nuk kujdesen shumica e njerëzve.

Me të gjitha këto probleme dhe obligime të nduarnduarta bënte më tepër ibadet se sa që izolohet nga familja dhe shoqëria dhe rrin i vetmuar nëpër manastire dhe shpella. Kjo praktikë e mosndarjes së dunjasë dhe ahiretit na tregon shembëlltyrën e pashoq të tij në historinë njerëzore.

Si mos të jetë Muhammedi a.s. në shkallën më të lartë të ibadetit pasi që ai është zbatuesi më i sinqetë dhe më i denjë i urdhërave të All-llahut xh.sh. qoftë ajo me namaz, dhikër, lutje e tjera (shih ajetet kur'anore): “O ti i mbështjell! Ngrihu për falje natën përveç një pjese të saj. Gjysmën e saj ose diç më pak se gjysmën. Ose shto diç prej saj dhe Kur'anin lexoje me vëmendje. Ne do të shpallim ty fjalë të rënd (të madhe). E s'ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë”.²⁰

“Dhe një pjesë të natës zgjohu me të (Kur'anin-namazin) është e sigurt se Zoti yt do të ngrëjë ty në një vend të lartë”.²¹ “Dhe falu për hirë të Tij në një kohë të natës, mandej adhuroje Atë edhe natën më gjatë”.²²

²⁰ Kur'ani: Muzzemmil 1-6

²¹ Kur'ani: Isra'ë, 79

²² Kur'ani: Insan, 26

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË ZUHD

- Ecni që të ndjekim rrugën e Muhammedit a.s. në Zuhd (asketizëm) për moslakminë e tij ndaj stolive të kësaj bote. Abdullah ibën Mes'udi thotë: "Hyra në shtëpinë e Muhammedit a.s. e ai ishte ulur në një hastër e cila në trupin e tij kishte lënë gjurmët e veta dhe i thashë: O i Dërguar i All-llahut, sikur të kishim gjetur të shtrojmë diç mbi hastër (që të të mbrojë). Pejgamberi a.s. tha: "Ç'kam unë dhe dunjaja, unë dhe dunjaja jemi sikur një kalorës i cili pushon nën hijen e një druri, pastaj ngutet dhe e lë atë (hijen)". Në shumë raste Muhammedi a.s. i është lutur All-llahut xh.sh. duke thënë: "O Zot, jepi familjes së Muhammedit begati aq sa ka nevojë".

Buhariu transmeton prej Aishes r.a. se ajo i ka thënë Urves: "O biri i motrës sime, shumë raste pritnim hënën, përsëri hënën (tri herë), hënën e re dhe kështu kalonim dy muaj të plotë duke mos ndezur zjarrë në shtëpinë e Muhammedit a.s. (d.m.th. nuk kanë zier as nuk kanë pjekur gjë, sh.p.). I thashë: Oj tezja ime, po çka ka qenë ushqimi juaj? Ajo tha: Hurmat dhe uji, me përjashtim kur disa prej fqinjëve ensarë (sipas mundësisë) na sillnin qumësht"! Ibën Xheriri transmeton prej Aishes r.a. se ajo ka thënë: "Muhammedi a.s. nuk është ngopur me bukë të grurit tre ditë me radhë, prej kur ka ardhur në Medine e derisa ka ndërruar jetë". Ahmedi transmeton prej Enesit

r.a. se ai thotë: "Fatimja i ka ofruar Pejgamberit a.s. kafshata të bukës së elbit, kurse ai kishte thënë: Ky është ushqimi i parë që babai yt e han pas tre ditëve".

Po si mos të jetë Muhammedi a.s. në shkallën më të lartë të zuhdit, kur ai është zbatuesi i asaj me të cilën e ka obliguar All-llahu xh.sh...

"Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para"²³. "Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarëve) e për t'i sprovuar me të, sepse shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe i përjetshëm"²⁴.

Rini, Muhammedi a.s. e ka obliguar veten me kënaqësi ndaj të paktës dhe, nuk ka lakmuar jetën e shfrenuar, nga kjo nuk duhet të kuptojmë se, ai ka dashur t'i bëjë haram vetes dhe familjes së tij, stolitë dhe ushqimet e pastërta të cilat All-llahu xh.sh. i ka krijuar për njerëzit... Nuk mund të paramendohet se ai ka pasur për qëllim këtë, por përkundrazi, ai nuk e ka pëlqyer as që ka pranuar që disa as'habë të vet të cilët

²³ Kur'ani: Duha, 4

²⁴ Kur'ani: TaHa, 131

tentonin të ia bëjnë haram, ngrënjen e mishit të pastër, shfrytëzimin e begative të kësaj bote, e poashtu kanë dashur që t'ia bëjnë obligim vetës agjërimin edhe natën. Poashtu nuk duhet kuptuar se Muhammedi a.s. është pajtuar me jetë modeste për shkak të varfërisë ose pamundësisë që të ofrojë ushqim për vete. Sikur të dëshironte luksoz të kësaj bote do t'i vinte bota para vetës e nënshtruar, por zuhdi i tij ka pasur qëllime e qëllime, por do t'i cekim disa prej tyre:

1. Ai pati për qëllim që me zuhdin, gjeneratave islame t'ua mësojë domethënien e dashurisë ndaj Zotit xh.sh., barazisë etj. Bejhekiu transmeton nga Aishja r.a. se ajo ka thënë: “Nuk është ngopur Muhammedi a.s. tre ditë me radhë, po sikur të donim do të ngopeshim, por ai përparësi i jepte të tjerëve”. Argumentet qartë tregojnë se ai kur shpërndante diç, atë e bënte duke mos pasur frikë nga varfëria.

2. Ka dashur ti edukojë gjeneratat islame me jetën e rëndomtë dhe modeste. Është frikësuar që të mos i pengojë luksi i jetës së kësaj bote dhe sprovimi i saj nga obligimi i thirrjes në Islam dhe lufta në rrugën e All-llahut xh.sh. të mos i shkatërrojnë luksi dhe zhytja në tubimin e pasurisë së tepërt nga ngritja e fjalës së All-llahut xh.sh. poashtu duke u frikësuar që kjo jetë mos t'i preokupojë për së tepërmi dhe t'i shkatërrojë siç i shkatërroi ata që kaluan para tyre.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë prej Ebu Ubejdes r.a. kur arriti me një pasuri nga Bahrejni dolën në pritje ensarët pas namazit të sabahut, Pejgamberi a.s. (kur i pa ata) u buzëqesh dhe tha: “Mendoj se Ebu Ubejdi ka arritur nga Bahrejni dhe ka sjellë pasuri. Ata thanë: Po o i Dërguar i All-llahut. Pejgamberi a.s. tha: “Përgëzoni dhe shfrytëzoni çka ju ofrohet, betohem në All-llahun se nuk e kam frikë varfërinë por kam drojë se do t'u hapen dyert e pasurisë dhe jetës së shfrenuar, si atyre para jush dhe do të bëni gara në grumbullimin e pasurisë sikur që bënin gara ata dhe, do të zhdukeni sikur që u zhduken ata që ishin më parë”.

3. Pejgamberi a.s. pati për qëllim t'ua bën të ditur munafikëve (dyfytërshave) dhe armiqëve të Islamit të cilët ishin të sëmurë në zemrat e tyre se ai (Muhammedi a.s.) me thirrjen e tij në Islam nuk pati për qëllim grumbullimin e pasurisë e as të stolive të përkohëshme të kësaj bote kalimtare, as kënaqësitë e as jetën e shfrenuar, as që ka patur për qëllim të përfitojë dunjanë në emër të fesë, por pati për qëllim vetëm shpërblimin e All-llahut xh.sh. dhe që të del para Tij duke mos pasur nga begatitë e kësaj bote, përpos ushqimit që i ka mjaftuar për një natë dhe rrobeve me të cilat mbulonte trupin, kurse ajo që mbetej në shtëpinë e tij prej rrobave dhe të hollave e jepte sadakë (lëmoshë).

Kjo është sjellje e tij dhe e Pejgamberëve para tij.

“O populli im unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm tek All-llahu”.²⁵

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË MODESTI

Ejani të ndjekim shembëlltyrën më të lartë të modestisë, e cila ka qenë e ngulitur thellë në personalitetin më të dalluar dhe më të shkathët ndër arabët dhe ndër popujt tjerë, Muhammedin a.s.; pra ju dhurojmë rini një reflektim nga modestia e tij e paskajshme, nga morali i tij i pafund me qëllim që të njihni etikën dhe sjelljen e Muhammedit a.s., modestinë dhe urtësinë e tij ndaj të tjerëve...

- Të gjithë ata të cilët kanë jetuar dhe kanë parë Pejgamberin a.s. janë në pajtim se ai gjithmonë i ka përshëndetur shokët e tij i pari dhe krejtësisht është përqëndruar kah bashkëbiseduesi i tij pa marrë parasysh moshën. Gjatë përshëndetjes nuk ia lëshonte dorën tjetrit përderisa ai ia lëshon (dorën), nuk zgjidhte vendin e uljes, por aty ku ishte vendi aty ulej, dilte në treg, vet mbante rrobet e tija dhe thoshte; “Mua më takon që t’i barti”, nuk mbahej i madh, punonte si të tjerët... gjatë ndërtimit të xhamisë së Medinës, gjatë hapjes së Hendekut, u përgjigjej ftesave pa marrë parasysh ftesën nga i liri apo robi, pranonte arsyetimin e çdokujt, rrobet e veta vet i arrnonte, vet i pastronte nallet (të mbathurat) e veta, i ndihmonte familjes, e lidhte deven, hante me shërbëtorin e vet, i zgjate dorën të dobëtit dhe nevojtarit, ulej thjesht në tokë... Po si të mos jetë i këtillë pasi që All-llahu xh.sh. e ka edukuar me edukatën e Kur’anit.

“E të jeshë i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty”.²⁶

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË MËSHIRË DHE BUTËSI

Ejani të ndjekim shembëlltyrën e tij në mëshirë dhe butësi me të cilën kishte arritur shkallën më të lartë qoftë ajo në faljen e të tjerëve, butësinë ndaj (sjelljes arrogante) beduinëve apo sjellja e tij pas fitores, ose gjatë problemeve që ka pasë me kundërshtarët; butësinë e tij ndaj asaj që ka përjetuar nga ashpërsia e beduinëve, për këtë të fundit do t’i cekim këta dy shembuj:

a) Buhariu transmeton prej Abdullahut r.a. ku ai thotë: “Pas fitores së Hunejnit ju shpërndaui plaçkën e luftës njerëzve, Akreë ibën Habisit i dha njëqind deve e po aq edhe Ujejniti poashtuedhe të tjerëve u ndau”. Një njeri tha: “Me të vërtetë kjo ndarje

²⁵ Kur’ani: Hud, 29

²⁶ Kur’ani: Shuara, 215

nuk është e drejtë e as për hirë të Zotit”. Unë atij i thashë: “Pasha All-llahun për këtë do ta lajmëroj Pejgamberin a.s.”. Shkova te ai, e lajmërova e ai shtoi: “Po kush do të ndajë drejtë nëse nuk ndanë drejtë All-llahu dhe Pejgamberi! All-llahu e mëshiroftë Musain që është munduar më shumë se unë dhe ka duruar!”.

b) Buhariu dhe Muslimi transmetojnë prej Enesit r.a. ku ai thotë: “Isha duke ecur me Resulullahun s.a.v.s. dhe ai kishte një xhubë të trashë, arriti një beduin dhe e kapi për të, e tërhoqi me të fortë dhe e pashë se në qafën e Muhammedit a.s. kishin mbetur gjurmët, pastaj tha: “O Muhammed, më jep diç nga pasuria e All-llahut”. Pejgamberi a.s. u kthye kah ai, u buzëqesh dhe urdhëroi që t’i jepet atij prej pasurisë me të cilën dispononim”. Ndërsa armiqëve si shembull për sjelljen e tij të urtë ua cekim shembullin e sjelljes së tij ndaj mekasve të cilët e kishin munduar, torturuar, persekutuar pa masë, e kishin dëbuar nga vendlindja, kishin planifikuar likuidimin e tij, e kishin akuzuar me lloj-lloj akuzash.

Që ta keni më të qartë personalitetin dhe pasqyrën e urtësisë, moralin e lartë të tij, të përcjellim atë se si reagoi në momentet e fitores së madhe të tij gjatë çlirimit të Mekës, kur ai ishte udhëheqës i një ushtrie të madhe të cilën nuk e kishte asnjëherë më parë gadishulli Arabik, kur e kishin çliruar Mekën dhe kishin shkelur mbi tokën e saj kuajt e tij kur mbizotëroi mëshira dhe butësia e tij. Paritë të cilët kishin tepruar me dënim në tokë dhe kishin vepruar siç është më keq me Pejgamberin a.s., pranohen tek ai me mirësi dhe me respekt, ua fali të kaluarën në mënyrë më njerëzore. Sunduesit e asaj kohe nuk dinin asgjë tjetër përpos që kundërshtarëve të vet t’ua hiqnin kokat. Muhammedi a.s. nuk bëri asgjë tjetër përpos që i tuboi ata dhe e tha fjalën e vet të pashembullt: “Ç’mendonit se çka do të bëjë me ju?” dhe tha: “Shkoni se jeni të lirë”. Pse jo, pasi All-llahu xh.sh. e ka udhëzuar me Kur’an. “Ti (Muhammed) fal, urdhëro për të mirë dhe largohu prej të paditurve”²⁷. “... e ti (Muhammed) sillu njerëzishmëri”.²⁸

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË KUJDESIN NDAJ SHËNDETIT DHE FUQISË FIZIKE

Urdhëroni që ta ndjekim shembëlltyrën e tij në fuqinë fizikeme të cilën ua kalonte të gjithëve, për këtë na dëshmojnë shumë shembuj:

²⁷ Kur’ani: Araf, 199

²⁸ Kur’ani: Hixhr, 85

1. E ka mundur Rukjanin i cili ka qenë më i fuqishmi i asaj kohe. Pasiqë Rukjani provoi tri herë dhe pësiso disfatë tha: “Dëshmoj se ti je i Dërguari i All-llahut”.
2. Muhammedi a.s. në betejën e Uhudit është ballafaquar me Ebi bin Halefin të cilin e goditi në gjoksin e tij, ai ra prej kali për tokë i vdekur duke e mbuluar gjaku.
3. Shokët e tij gjatë hapjes së Hendekut ktheheshin tek ai kur hasnin në ndonjë gur të fortë dhe ai e thente.
4. As’habët, kur lufta ashpërsohej kërkonin ndihmë pasiqë e dinin qëndrimin, guximin dhe trimërinë e tij...
5. Po si të mos jetë shembëlltyra më e lartë e fuqisë pasi që ai thotë: “Besimtari i fuqishëm është më i dobishëm dhe më i dashur tek All-llahu xh.sh. se sa ai i dobëti”.²⁹
6. Po si të mos jetë shembull në përgatitje, fuqi dhe trimëri pasi All-llahu xh.sh. qartazi i ka shpallur në Kur’an.

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për beteja kundër atyre (që tradhëtojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj...”.³⁰

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË TRIMËRI

Urdhëroni të ndjekim shembëlltyrën e tij në trimëri në kohën e xhahilijetit dhe kohën Islame, për trimërinë e tij. Shembëlltyra e tij ju obligon që të mos i frikoheni tiranit, mizorit, mos ta keni frikë armikun, për derisa jeni të udhëzuar në Islam.

Trimëria e tij është hetuar gjatë tërë jetës së tij. Gjatë fëmijërisë i është porositur që të betohet për Latin dhe Uzzanë (dy idhujt kryesorë të mekasve) e në këtë ai tha: “Mos më lutni diçka për ta, se betohem në All-llahun se asnjë gjë nuk e urrej, sa që i urrej këta dy”. Ky fëmijë me kaq guxim flet kundër zotërave të popullit dhe nuk frikësohet nga rreziku që i kanosej.

Këto janë disa detaje nga guximshmëria e tij në jetën rinore, por shembujt të cilët kemi për qëllim dhe ata ndaj të cilëve u përkulen trimat e botës janë ato ngjarje të cilat kanë ndodhur gjatë kohës së Pejgamberisë pas shpalljes pasi që porositet të thërret haptazi, pas shpërnguljes në Medine. Për këtë na dëshmon fjala e Aliut r.a. ku thotë: “Kur

²⁹ Transmeton: Muslimi

³⁰ Kur’ani: Enfal, 60

paraqitet ndonjë rrezik, kur ashpësohet lufta dhe ndihej trishtimi drejtoheshin nga ai dhe askush nuk ndihej më afër armikut se sa ai”.

Ja edhe dy shembuj të cilët janë argument më i madh për trimërinë luftarake të tij:

1. Banorët e Medinës një natë u trishtuan, u dëgjua një zë i llahtarshëm, medinasit u drejtuan kah vendi i ngjarjes, kur arritën e gjetën Muhammedin a.s. i cili kishte arritur para tyre, duke u kthyer me shpatë në dorë i lajmëroi dhe u tha që të mos trishtohen sepse ai ishte kali i Ebu Talhas.

2. Në betejën e Hunejnit qëndronte i hipur përmbi mushkën e vet, kur njerëzit iknin u thoshte: “Unë jam Pejgamber”

“Unë jam i biri i Abdul Mutalibit”.

Atë ditë Muhammedi a.s. ishte personi më i qëndrueshëm i cili rrinte më afër armikut. I kam zgjedhur këto dy ndodhi nga ndodhitë e shumta pasi që Pejgamberi a.s. në të parën ndodhi nxitoi kah vendi i rrezikut. Në të dytën ndodhi Pejgamberi a.s. qëndroi i paluhatshtëm në luftë kur të tjerët ikën; ata që kanë njohuri luftarake e dinë se në këto dy raste duket trimëria sepse kah rreziku i cili kanoset gjithnjë vepron i pari, aty duket durimi në rastet kur mbizotëron rreziku dhe frika. Dhe si të mos jetë ai (Muhammedi a.s.) trim, në momentet më të rrezikshme dhe më të vështira, pasi që All-llahu xh.sh. e ka urdhëruar në Kur’an: “O Pejgamber, lufto jobesimtarët e hipokritët dhe sillu rreptë ndaj tyre...”³¹

“A ju frikësoheni atyre? Më e drejtë është që t’i frikësoheni All-llahut, nëse jeni besimtarë.”³²

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË KOMUNIKIMIN ME NJERËZ DHE KOORDINIMIN DHE RREGULLIMIN E ÇËSHTJEVE POLITIKO- SHOQËRORE
Ejani ta ndjekim shembëlltyrën e tij në komunikimin me njerëz e cila duhet të mirret si shembull si për ata të moshës fëmijërore apo të rritur, besimtarë apo jobesimtarë, pasi që ka qenë i pajisur me moral të lartë dhe ka poseduar një mënyrë të komunikimit me urtësi, çdo gjë e ka vënë në vendin e vet. Rini, kjo mënyrë e urtë e të komunikuarit

³¹ Kur’ani: Tewbe, 73

³² Kur’ani: Tewbe, 13

qartazi shihet në bashkëpunimin e tij me shokët e vet poashtu edhe qëndrimi i tij ndaj armiqëve, të udhëhequrit e shtetit...

Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit të tij me shokët e vet, i ka përfituar zemrat e tyre me moralin e tij, në shpirtërat e tyre lartë ishte ngritur me butësinë dhe urtësinë e tij. Muslimi transmeton se Muadh bin Hakem es-Selemi një ditë i ka thënë: Unë duke u falur me Pejgamberin a.s. një njeri prej xhematit më tha: “Jerhamukallah”, njerëzit më shikuan me habi, ndërsa unë thashë: “Ç’keni që më shikoni mua?” Filluan t’i bien prehërit me dorë, kur i pashë se duan të më heshtin, heshta, pasi që Pejgamberi a.s. u fal, vallahi nuk kam parë mësues dhe edukatorë më të mirë para dhe pas tij betohem në All-llahun xh.sh. se as s’më nënçmoi e as që më rrahu, por më tha: “Ky është namaz dhe në të nuk lejohen fjalët e njerëzve por, këtu nevojitet tesbih, tekbir dhe lexim të Kur’anit...”

Sa i përket qëndrimit të tij ndaj armiqëve kemi shembuj të shumtë. Më i njohuri është pageja e Hudejbisë në të cilën ai e pengoi luftën dhe grindjen mes tij dhe kureshitëve, e cila i ndihmoi më vonë shumë për çlirimin e Mekës dhe tërë gadishullit Arabik nga mbeturinat dhe ndytësitë e xhahilijetit.

Sa i përket rregullimit të shtetëror, politikanët në çdo kohë dhe vend janë pajtuar se Muhammedi a.s. ka pasur mençuri, urtësi, mendjeprehtësi, çdo gjë e planifikuar ashtu siç duhet, ka poseduar mendje të shëndoshë me të cilën ka arritur të tejkalojë çdo vështërsi dhe t’ia arrijë çdo qëllim; popullit të vet i ka ofruar fuqinë dhe nderin. Për popullin musliman pas tij ka programuar ç’i nevojitet prej famës, fuqisë dhe autoritetit.

Prej asaj dite që këmba e tij shkeli në tokën e Medine Muneveres filloi menjëherë ngritja e xhamisë së tij të ndershme e cila luajti rolin e faltores, parlamentit, vendit për pushtet, organ ekzekutiv, prej aty buronte thirrja islame, ligji për të gjithë njerëzinë, prej aty ushtria muslimane startonte në sipërfaqen e tokës duke çliruar vende të shumta, aty pritëshin delegacionet, përhapej dituria dhe zgjidheshin problemet e njerëzve.

Pas një kohe të shkurtër, Muhammedi a.s. ngriti në popullin e Medinës unitetin e fortë islamik nën simbolin e vëllazërimit ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve (mekasëve dhe medinasëve). Në simbolin e pajtimit ndërmjet fisit Evs dhe Hazrexh derisa të gjithë u bënë vëllazër të devotshëm në emër të All-llahut xh.sh., të lidhur fortë ndërmjet njëri-tjetrit. Nga ky vëllazërim i singertë, rezultoi çlirimi dhe dëbimi i çifutëve të Medinës, çlirimi i Mekës nga idujtarët, ngritja e shtetit Islam në gadishullin Arabik.

Sikur Muhammedi a.s. të mos kishte këto cilësi të vlefshme, këtë zgjuarësi, aftësi për udhëheqësi politike dhe ushtarake, nuk do të kishte mundësi që ta formojë shtetin Islam në Medine e as që do t'i nënshtrohej atij gadishulli Arabik me dashuri dhe ngrohtësi. Si mos të jetë Pejgamberi a.s. shembëlltyrë në politikën e tij dhe në komunikimin e tij me shokët e vet, kur ai që personi i cili në përpikëri zbatoi porositë e All-llahut xh.sh., dhe ai këtyre porosive gjithmonë u është përmbajtur. Dëgjoni këshillat dhe porositë e All-llahut të cilat ia bënë Pejgamberit a.s.: “Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë dhe zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultuhu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten”.³³

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË QËNDRUESHMËRINË NDAJ PARIMEVE

Tani do të ndjekim shembullin e qëndrueshmërisë në parimin i cili ka qenë cilësi dhe dukuri e pandashme e tij. Në thirrjen Islame nuk kanë mundur ta pengojnë erërat e ndryshme sado që kanë fryrë, nga komunikimi i misionit të tij si i Dërguar i All-llahut xh.sh. nuk kanë mundur që ta largojnë pengesat qëllim këqija sado që i janë kanosur. Dhe çdo herë që gjendja e tij vështirësohej dhe preokupohej nga maltretimet dhe mundimet, qëndrueshmëria dhe besimi i tij shtoheshin, bëhej këmbëngulës dhe më i bindur dhe nuk zgjidhte rrugë tjetër përpos që t'i drejtohet All-llahut që ta mëshirojë dhe t'i jep fitore: “O Zot, Ty ta paraqes dobësinë dhe pamundësinë time, nënçmimin e njerëzve që ma bëjnë mua, o i Mëshirshëm i mëshiruesve, Ti je ndihmues i të pafuqishmëve, Ti je Zoti im, në duar të cilit po më lë?! Të një i largët i cili nuk më njeh apo në duar të armikut i cili do të më nënshton mua, nëse Ti nuk je i hidhëruar në mua (tërë këtyre vuajtjeve nuk u jap rëndësi), por mëshira Jote është më e dashur tek unë, kërkoj ndihmë nga drita Jote e cila e ndriçon të gjitha errësirat, zbukuron jetën e kësaj bote dhe ahiretit, që të mos hidhërohesh, se nuk ka mbrojtës dhe ndihmës përveç Teje”.

Ju rini, duhet përkujtuar rastin kur kurejshitet e kanë munduar në mënyra të ndryshme Muhammedin a.s., e kanë provokuar në një rast derisa ashpërsia e tyre arriti kulminacionin kur ata e gjuajtën me gurë, ia mbuluan kokën me dhe derisa arriti bija e tij Fatimja t'ia pastrojë dheun duke quajtur: “Pikëllim më të madh në zemrën e tij nuk kishte se sa kur e dëgjoi bijën e vet duke qajtur, loti i saj e preku thellë në zemër, po

³³ Kur'ani: Ali Imran, 159

pse jo, kur ai ishte më i mëshirshmi dhe më i urti në mesin e njerëzve. Por, ç'bëri Pejgamberi ynë i dashur, në këtë gjendje trishtuese kur ai ndjente thellë në shpirt vuajtjet, tha: Mos u pikëllo Fatime se All-llahu do ta mbrojë babain tënd, pasha Zotin nuk kanë mundur të më bëjnë gjë të keqe kurejshitet derisa ndërroi jetë Ebu Talibi".

Ju të gjithë rini e nderuar e dini qëndrimin e Pejgamberit a.s. ndaj axhës së vet Ebu Talibit kur mendoi se ai do t'u dorëzojë atë (Muhammedin a.s.) mushrikëve ose nuk do ta përkrahë më... Ja të ndalemi pak të dëgjojmë fjalët e së vërtetës të cilat buronin nga besimi i thellë, nga zemra e pastër, shprehje këto të cilat nxjerrin në pah vendosmërinë e tij në parimet të cilat përsëriteshin nga goja e Pejgamberit a.s. që para botës të shpallë se si është bindja dhe qëndrimi ndaj parimeve, si sprovohen burrat dhe trimat: "O axha im, pasha All-llahun, sikur diellin të ma vënin mbi krahun e djathtë dhe hënën në të majtin që ta lë (braktis) këtë mision, nuk do ta lë përderisa e vërteta të dal në shesh, apo të zhdukem". Pastaj u ngrit dhe ktheu shpinën duke qarë. Kur axha i tij e pa vendosmërinë e tij të sigurtë dhe të thellë ndaj këtij misioni, e thirri dhe i tha: "O biri i vëllaut tim, vazhdo dhe prediko atë që don, se pasha All-llahun nuk kam për të dorëzuar asnjëherë". "Pasha Zotin nuk do të arrijnë te ti derisa unë të shtrihem në tokë i vdekur".

Poashtu, ju rini, e dini se mushrikët kanë përdorur çdo mënyrë dhe metodë që ta pengojnë nga misioni dhe predikimi i tij, mirëpo këto metoda dhe mënyra të vrazhda aspak nuk ndikuan e ai as që iu përgjigj kërkesave të tyre e as që u dorëzua. Ata përdorën metoda mashtruese dhe kërcënuese, mirëpo ai aspak nuk u luhat. Atë e nënçmonin, akuzonin, përqeshnin... por asnjëherë nuk u nënshtrua. Përdorën metodat e distancimit dhe ndërprerjes totale të marrëdhënieve me të dhe me ata që e ndiqnin rrugën e tij. Më në fund vendosën që ta zënë atë dhe ta vrasin, por as që u përkul e as që u nënshtrua.

Pas hixhretit, mushrikët i luftuan muslimanët me tërë arsenalin ushtarak të cilin e posedonin, në luftime të ashpra, që ta zhdukin misionin e tij dhe ta shpartallojnë atë shoqëri, por kjo aspak nuk e pengoi nga të lartësuarit e fjalës së All-llahut xh.sh. dhe në predikimin e thirrjes (da'wes) Islame para botës.

Muhammedi a.s. duke vazhduar rrugën në predikimin e Islamit dhe xhihadin e kësaj feje, duke duruar ndaj torturave dhe provokimeve, arriti që këtë fe (Islam) njerëzit ta pranojnë grupe- grupe. Dhe më në fund, Islami ngadhënjëu, u formua shteti Islam. E gjithë kjo u arrit me ndihmën dhe vendosmërinë e tij në misionin Islam. Si mos t'i ketë këto cilësi të dalluara siç janë bindja e thellë dhe qëndrimi i paluhatshëm ndaj

parimeve pasi që, All-llahu e ka urdhëruar në Kur'an: "O ti i Dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (komunikimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën- risalen)"³⁴

"Ti (o Muhammed) duro, ashtu sikur duruan të dërguarit e vendosur"³⁵.

MUHAMMEDI A.S. SHEMBËLLTYRË NË ORATORI DHE NË TË FOLURIT E GJUHËS SË PASTËR DHE TË QARTË

Më në fund dua t'u përkujtoj me një shembëlltyrë që ka vlerën e vet me të cilën dallohet i riu musliman nga të tjerët e ajo është, të folurit e gjuhës së pastër, oratoria, sjellja e mirë gjatë bisedës me të tjerët dhe njohja e rregullave të bisedës.

Ejani të marrim shembuj nga më oratori i arabëve, nga më i shkathti në oratori. Muhammedi a.s. ka qenë ai i cili gjithmonë ka folur fjalë të qarta dhe të kuptueshme, nëse dëgjuesi do të kishte dashur t'ia numëron fjalët, kishte edhe atë mundësi sepse fjalët e tij ishin të qarta. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë prej Aishes r.a. e cila thotë: "Pejgamberi a.s. nuk i radhite fjalët njëra pas tjetrës siç i radhitni ju, por kur ka folur ai, dëgjuesi mundte t'ia numërojë (fjalët)". Ebu Dabudi transmeton prej Ajshës e cila thotë: "Fjalët e Pejgamberit a.s. kanë qenë të ndara dhe çdo kush i ka kuptuar". Buhariu dhe Muslimi transmetojnë prej Enesit r.a. i cili thotë: "Kur ka folur, fjalën e ka përsëritur tre herë derisa është kuptuar, assesi nuk ka shpejtuar, ka urrejtur të folurit e pandërprerë, të folurit pa nevojë, të ngarkuarit e vetvetes në të folur, mendjemadhësinë, të folurit e fjalëve të pakuptueshme".

Në Sunen ebi Davudi dhe Trimidhiu transmetojnë prej Omerit a.s. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "All-llahu i urren ata të cilët e ngarkojnë veten në të folur (për të zgjedhur fjalët të mëdha sh.p) dhe ata që përtypin fjalët si kafsha ushqimin".

Kontaktimi i tij dhe sjellja nëpër tubime është shembull për ne. Në bisedat e tij ka qenë modest, nuk i ka zgjedhur njerëzit është drejtuar kah ata që kanë më tepër autoritet, për këtë më së miri na tregon rasti me Amër ibn Asit ku ai thotë: Pejgamberi a.s. duke biseduar në një mexhlis ishte drejtuar kah unë dhe pas një çasti e pyeta: "O Pejgamber i All-llahut, a jamë unë më i mirë apo Ebu Bekri?" Tha: "Ebu Bekri". Pastaj thashë: "A jam unë më i mirë apo Omeri?" Tha: "Omeri". Pastaj pyeta: "A unë jam më i mirë apo

³⁴ Kur'ani: Maide, 67

³⁵ Kur'ani: Ahkaf, 35

Othmani?" Tha: "Otmani". Pasiqë e pyeta atë (Muhammedin a.s.) e ktheu shpinën dhe unë u pendova dhe thashë: "Sikur mos ta kisha pyetur"³⁶.

Pejgamberi a.s. gjithmonë ka qenë i disponuar, në fytyrën e tij është vërejtur gëzimi, çdoherë ka qenë i buzëqeshur. Bezari transmeton nga Xhabiri r.a. ku thotë: "Kur i vinte shpallja ose ligjëronte, thoj: "Paralajmëronte se dënimi është afër dhe kur ndërprehej (vahji) ose, e përfundonte ligjeratën, ishte njeriu më i disponuar, sihariqtar më i madh, nuk i shtrinte këmba para shokëve të tij". Pejgamberi a.s. kur ligjëronte nuk linte zbrazëtira (në mënyrë precize i sqaronte edhe imtësitat, sh.p.) e as që i bezdiste njerëzit.

Ebu Davudi transmeton prej Xhabir bin Semres se Pejganberi a.s. nuk e ka tepruar ligjërimin të premtën por ka folur fjalë të numëruara (të kuptueshme dhe të qarta sh.p.). Poashtu gjatë ligjërimin ndryshonte pamja e tij sepse i kushtonte rëndësi dhe kujdes asaj që fliste e ky ndryshim në pamje shihej në fytyrën e tij.

Muslimi transmeton nga Xhabiri r.a. se Pejgamberi a.s. kur ka ligjëruar është hidhëruar, e ka ngritur zërin, i janë skuqur sytë sikur të urdhëronte ushtrinë për luftë dhe tregon se në mënyrë alegorike u është drejtuar: "Jeta juaj është prej mëngjesi deri në mbrëmje". Këtë e ka për qëllim motoja: "Pejgamberi është prijësi ynë".

Këtë që kemi cekur nuk është asgjë tjetër përpos një pikë ujë nga deti i meritave të mëdha të tij dhe një grusht ujë nga deti i karakteristikave dhe cilësive të panumërta të Muhammedit a.s., e kush dëshiron më shumë shembuj në këtë aspekt le të urdhëron dhe le të lexon se ç'kanë shkruar historianët, ç'kanë regjistruar muhadithët, nëse doni të shëroheni dhe të shuani kërshërinë! Nuk ka tjetër rrugë përpos se të bëhemi më të vendosur dhe të unjësojmë qëllimin që të ndjekim përsosshmërinë njerëzore të ngulitur në qenien e personalitetit të Muhammedit a.s. Kjo u bën juve (rini) që të dalloheni nga të gjithë në çdo pikëpamje, u bën të dalluar në Ibadet, në zuhd, modesti, oratori, urtësi, në qëndrueshmëri ndaj parimeve, në sjellje të mira etj.

Dhe, po atë kur do ta zbatoni fjalën e dhënë "Muhammedi a.s. është prijësi ynë" atëherë i keni argumentuar botës se ju jeni popull i cili punon e nuk flet, veproni dhe nuk vetëreklamoheni. Në atë çast do të fitoni besimin e njerëzve dhe njerëzit do t'i përgjigjen thirrjes suaj. Fjalët tuaja do të kenë ndikim dhe shumë njerëz do të afrohen në radhët tuaja. Do t'ju përkrahin në arritjen e qëllimeve tuaja dhe vetëm një kohë të

³⁶ Transmeton: Taberaniu

shkurtër do të kalojë kur do të lind shteti Islam. Ai shtet do të jetë më krenar, më i fuqishëm dhe atëherë besimtarët do të gëzohen me ndihmën e All-llahut xh.sh., i cili i ndihmon kujt të dojë sepse Ai është i Fuqishëm dhe i Urtë.

KUR'ANI ËSHTË KUSHTETUTA JONË

A e dini rini se ç' domethënie ka motoja "Kur'ani kushtetuta jonë"?

Ajo do të thotë të besoni nga thellësia e zemrës, nga ndërgjegjja e juaj e pastër se me të vërtetë ky Kur'an i madhëruar është libër i All-llahut xh.sh. të cilin Ai i ka shpallur Muhammedit a.s. të birit të Abdullahut që të jetë sihariqarë dhe qortues për të gjitha botërat. Për këtë na dëshmon Kur'ani a.sh. ku thotë: "Falenderimi i takon vetëm All-llahut që ia shpalli robit të vet Librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërthënie. (Ia shpalli) të saktë (pa shmangie) për t'ua tërhequr vërejtjen (atyre që nuk besojnë) ndaj një dënimi të rëndë prej Tij, e për t'i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm".³⁷

Poashtu duhet të dini se konkurenca që të sillet një libër si ai (Kur'ani) qëndron prej ditës që ka filluar shpallja e derisa të ekziston kjo botë. "Thuaj: edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinnët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund ta bënin si ky sado që do ta ndihmonin njëri-tjetri"³⁸

Duhet të shpallni para botës se kush e ndjek rrugën e Kur'anit dhe parimet e tij ata janë të më të udhëzuarit dhe në rrugën më të drejtë dhe më të sigurtë. "Juve ju erdhi nga All-llahu drita dhe Libri i qartë. All-llahu e vë me atë (Kur'anin) në rrugën e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e tij i nxjerrë ata nga errësitat në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë".³⁹

Duhet njerëzve t'u shpjegohet se Kur'ani nuk është libër i ndonjë populli apo shoqërie të veçantë, po është i të gjithë popujve dhe shoqërive, gjegjësisht për tërë njerëzimin. "Ai (All-llahu) që ia shpalli Furkanin (Kur'anin, dallues në mes të vërtetës dhe të pavërtetës) robit të vet (Muhammedit a.s.) që të bëhet Pejgamber i botës këshillues".⁴⁰

Pra, ju duhet që të shpallni me dije të plotë se kush ia kthen shpinën Kur'anit dhe largohet nga rruga e tij, ai ka gabuar dhe ka ra nën influencën e injorancës, e ka

³⁷ Kur'ani: Kehf, 1-3

³⁸ Kur'ani: Isra, 88

³⁹ Kur'ani: Maide, 15-16

⁴⁰ Kur'ani: Furkan, 1

humbur dritën e zemrës. “E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kijametit do ta ringjallim të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: Zoti im, përse më ngrite të verbër kur unë isha me sy. Ai (All-llahu) thotë: Ashtu si i harrove argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu sot je i harruar”⁴¹

Në të njejtën kohë duhet qartazi të shpallim e të ngrisim zërin që të tingëllojë në veshin e atyre që s’e dinë se Kur’ani është kushtetutë, sistem jetësorë, rrugë për të fituar fuqinë, famën dhe ngadhnjimin. Kush devijon nga porositë e tij, humb rrugën, dështon dhe bëhet nga të humburit. All-llahu xh.sh. për refuzuesit e Kur’anit thotë:

“(Ta zbritëm) që edhe ti të gjykosh me atë që të zbriti All-llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që të zbriti All-llahu. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd), ti dije se All-llahu ka për qëllim t’i ndëshkojë ata për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës. A thua mos po kërkojmë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?”⁴²

SPECIFIKAT DHE VEÇORITË E SHERIATIT ISLAM

A e dini rini se shumica e atyre të cilët e quajnë veten musliman, dhe mendojnë se janë musliman, nuk dinë asgjë për veçoritë e këtij Kur’ani, as nga specifikat e shariatit të ndriçuar Islam. Andaj, sikur ta dinin nuk do të kishin këtë qëndrim pasiv ndaj Islamit e as që do t’ia kthenin shpinën Librit të All-llahut xh.sh. siç ia kanë kthyer, sepse njeriu gjithmonë është armik i asaj që nuk e din dhe nuk e njeh. Prandaj ne i cekim disa veçori të shariatit Islam dhe specifikat e tij duke shpresuar se rinia pasi ta kuptojë të vërtetën do t’i përmbahet dhe do t’i ikë dhe shmanget rrugës së gabuar.

“Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, ndërsa ajo (gënjeshtra) zhduket”⁴³

Këto veçori dhe specifika do t’i radhisim në pikat që vijojnë:

Ky ligj është shpallur nga All-llahu e nuk është i shpikur nga njerëzit. Është ligj i përbotshëm.

⁴¹ Kur’ani: TaHa, 124-126

⁴² Kur’ani: Maide, 49-50

⁴³ Kur’ani: Enbija, 18

(Islami) është ligj gjithëpërfshirës. Gjithnjë i begatshëm, aktual dhe përtrirës. Sheriati është ligj i drejtësisë absolute.

LIGJI I ALL-LLAHUT XH.SH.

Me fjalën Rebbanijetun nënkuptohet se dispozitat e këtij sheriati dhe themelet e tij nuk janë të vendosura nga njerëzit të cilët janë me të meta dhe hasin në pamundësi, as që ndikojnë në (sheriati) vendi, koha, gjendja, kultura, as që ka ndikime trashëgimia, psiqika e njeriut, mendja e tij... Por këtë ligj e ka sjellur Ai i cili krijon dhe sundon në këtë botë, i ka krijuar njerëzit dhe ai e din se ç'është e mirë për ta dhe ç'është e dobishme. Për këtë na flet ajeti i 14 i sures Mulk: "A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë".

Pikësynimi përfundimtar i këtij ligji është lidhshmëria në mes njeriut dhe All-llahut xh.sh., derisa bindshëm ta njoh Atë, t'i frikësohet dhe ta adhuron ashtu siç e meriton Ai, sepse ai (njeriu) për këtë është krijuar. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me ibadetin, por përfshin rregulla dhe norma që kanë të bëjnë me jetën familjare, civilizuese, ka të bëjë me jurispodencë, rregullimin shtetëror etj. E gjithë kjo për atë shkak se kjo fe është shpallur nga All-llahut xh.sh., dhe besimtarit nuk i lejohet që të bën seleksionim në dispozitat e sheriatis, sepse besimtar i vërtetë është ai i cili në mënyrë totale i pranon dispozitat e sheriatis. Për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: "Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër...".⁴⁴

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti as asaj para teje) derisa të mos të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndjejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden singërisht."⁴⁵

"E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues".⁴⁶

" E kush nuk vendos sipas asaj që All-llahu e zbriti, ata janë mizorë (të padrejtë)"⁴⁷

⁴⁴ Kur'ani: Ahzab, 36

⁴⁵ Kur'ani: Nisa, 65

⁴⁶ Kur'ani: Maide, 44

⁴⁷ Kur'ani: Maide, 45

“E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarët të dalë jashtë rrugës së Zotit”.⁴⁸

Mu për atë besimtarët i çmojnë dispozitat e sheriatit, i praktikojnë dhe përuhen ndaj këtij ligji hyjnor, gjë e cila nuk është rast me ligjet tjera të shpikura nga njeriu, pra respekt i veçantë i bëhet porosisë së All-llahut xh.sh.

“Po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut”.⁴⁹

LIGJI I PËRBOTSHËM

Me termin fe “e përbotshme” kemi për qëllim të tregojmë se sheriatu Islam me dispozitat, parimet dhe udhëzimet është sistem gjithë-njerëzor, pra ai është mëshirë për të gjitha botërat, udhërrëfyes për të gjithë njerëzit, nuk është sistem i ndonjë lloji të veçantë njerëzish apo për një kontinent të posaçëm, por vlenë për të gjithë njerëzit njësoj duke u nisur prej aty se ata të gjithë tek All-llahu xh.sh. janë njëjtë, i bardhë i zi, arab dhe joarab, pa marrë parasysh a janë ata në Lindje apo në Perëndim, ligji Islam nuk njih racizëm, nacionalizëm, shovenizëm, fanatizëm, nuk bëhet klasifikimi i njerëzve, por të gjithë njerëzit janë të barabartë. Se Islami është fe e përbotshme (pashtu edhe sheriatu) argumentojnë shumë ajete të Kur’anit:

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”.⁵⁰

“Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit myzhdedhënës (sihariqdhënës) dhe tërheqës i vërejtjes”.⁵¹

“Thuaj (Muhammed): O ju njerëz! Unë jam i Dërguari i All-llahut te të gjithë ju”.⁵²

Kjo është një nga veçoritë e këtij sheriatu sepse sikur të ishte nga ndonjë individ apo grup njerëzish, do të anonte kah populli i vet, vendlindja, klasa, interesi por ky sheriat është i vet All-llahut xh.sh., Zotit të të gjitha botrave dhe të gjithë njerëzve, të gjitha ato janë krijesa të Tij, nuk ka përparësi asnjë individ nga tjetri, asnjë grup nga grupi tjetër, duke u nisur nga ajo që të gjithë janë krijuar prej një materiali.

⁴⁸ Kur’ani: Maide, 47

⁴⁹ Kur’ani: Maide, 50

⁵⁰ Kur’ani: Enbija, 107

⁵¹ Kur’ani: Sebe’ë, 28

⁵² Kur’ani: A’raf, 158

LIGJI GJITHPËRFSHIRËS

Me fjalën “gjithë-përfshirës” nënkuptojmë se sheriati Islam është gjithë-përfshirës, pasi që ai përfshin në vete rregulla, dispozita dhe udhëzime jetike. Në çdo aspekt të ngritjes, përtëritjes në pikëpamje të besimit, ritualeve fetare (ibadeteve), moralit, në përgjithësi ka të bëjë me të gjitha ligjet dhe problemet shoqërore, jurispodencë, rregullimin e jetës familjare, ka të bëjë me sistemin shoqëror, marrëdhënie ndërkombëtare, norma të sistemit ekonomik, udhëzime për të arritur kah një shoqëri ideale...

E gjithë kjo bazohet në parime të sigurta dhe precize dhe në dispozita të shariatit të përhershëm i cili u ofron njerëzve atë që u nevojitet, njerëzve nuk u kërkon kompensim, bashkon e nuk ndan, afron e nuk largon, ndërton e nuk rrënon, i shpallur nga i Urti që i Vetmi meriton lëvdata dhe falënderime:

“Ne, ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për besimtarët”.⁵³

GJITHNJË I BEGATSHËM, AKTUAL DHE PËRTRITËS

Me fjalët “i begatshëm, aktual dhe përtritës” kemi për qëllim të themi se, sheriati Islam me parimet e gjithanshme të tij dhe me rregullat e përgjithshme njofton për nevojat e përditshme në jetën aktuale, të sotme e cila është dinamike, vlenë për etapa të ndryshme kohore të kulturave të lloj-llojshme sidomos në rregullat e Mu’amelatit (marrëdhëniet ndërkombëtare, ndër-njerëzore)...

Për këtë do të sjellim disa shembuj: Kur’ani Famëlartë në pikëpamje të kushtetutës dhe jurispodencës qartazi dhe konkretisht potencon në parimin e drejtësisë:

“Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë”.⁵⁴

“Dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë në mes të njerëzve”.⁵⁵

Ky parim të cilin e kanë cekur është një dispozitë e cila nuk ndryshon dhe sipas saj duhet punuar dhe sjellur në çdo kohë dhe vend, mënyra e zbatimit të parimit të drejtësisë i është lënë shekullit të përparimit, jetës dinamike, praktikimi i parimit të drejtësisë në një gjykatë ose në ca gjykata duke i ndarë organet e jurispodencës nga ato ekzekutive dhe nga ato ligdhënëse, e tërë kjo u është lënë në dispozicion njerëzve.

⁵³ Kur’ani: Nahl, 89

⁵⁴ Kur’ani: Maide, 8

⁵⁵ Kur’ani: Nisa, 58

Qëllimi parësor i sheriatit është zbatimi i parimit të drejtësisë, praktikimi në çfarëdo mënyre apo forme të cilën e parashohin ekspertët në këtë sferë nëse gjykata ia arrin qëllimit për drejtësinë e barabartë ndaj të gjithë njerëzve. Për shembull marrim parimin e të konsultuarit për të cilin flet ajeti:

“... dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta”,⁵⁶ parimi i barazisë, “Më i ndeshmi ndër ju është ai që më tepër është rujtur (nga të këqijat)...”,⁵⁷ në sistemin e mardhënieve tregtare “O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë...”⁵⁸, parime tjera shoqërore, rregulla kushtetare, ligje të ekonomisë...

Sa i përket çështjeve për të cilat nuk ka tekst origjinal, apo u nënshtrohet ixhtihadit të kohës, duke bërë analogji (krahasime) të sigurta, duke pasur parasysh atë që është më e dobishme dhe më e nevojshme ose argumente tjera në të cilat ulemaja kanë mundime të ndryshme. Për çështjet për të cilat nuk ka tekste dhe rreth të cilave diskutojnë dijetarët të thelluar në shkencë dhe në devotshmëri, nxjerrren dispozita me të cilat i afrohen asaj që është e dobishme dhe pajtohen me përparimin kulturor, shkoncor për këtë Islami thotë:

“Lejohet ndryshimi i dispozitave sipas nevojës së kohës”

Sa u përket çështjeve për të cilat ka tekste të prera, siç janë çështjet e akaidit, bazat e besimit, rregullat e ibadeteve, ndalimi i zinasë, kamatës, bixhozit, përcaktimi i pjesës së trashëgimit, kohëzgjatja e pritjes pas shkurorëzimit ose pas vdekjes së bashkëshortit (iddet) dhe të ngjajshme me ta, në këto sfera ku ka tekste të prera, nuk lejohet ixhtihadi as që mundësohet kurrfarë ndryshimi, dhe çdokush që mundohet të bëjë ndryshim apo reformë në të ai është shkatërrues i sheriatit, i ka shpallur luftë All-Illahut xh.sh. dhe Pejgamberit dhe “zhvishet” nga Islami. Për këtë çështje dijetarët e Usulit thonë:

“Nuk ka vend ixhtihadi aty ku ka tekst Kur’anor” (dhe hadith sh.p.)

Se sheriatu Islam është i përhershëm për çdo kohë dhe pandërprerë jep frytin e vet, ka norma ligjëdhënëse të nxjerrura nga burimet Islame, p.sh. “e keqja nuk ndërpritet me

⁵⁶ Kur’ani: Shurah, 38

⁵⁷ Kur’ani: Huxhurat, 13

⁵⁸ Kur’ani: Bekare, 282

të keqe”, “lejohej demë personal që të largohet demë i përgjithshëm”, “nevoja të ndaluarën e bën të lejuar”, “largimi i të keqes ka përparësi nga ajo që t sjell dobi”...

DREJTËSIA ABSOLUTE

Me sintagmën “Drejtësia Absolute” nënkuptojmë se sheriati Islam ka për qëllim jetësimin e drejtësisë absolute mes njerëzve në përgjithësi, vëllazërimin e sigurtë në mes tyre, mbrojtjen e gjakut të tyre, ruajtjen e nderit dhe pasurisë, lirisë së të menduarit siç ia mbron fenë dhe moralin.

Pra synimi final i tij është që njerëzit të jenë të kënaqur me jetën e tyre, edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Qëllimi i shariatit Islam, nuk është që t’i ofrojë mirësi, dobi ndonjë klase në mesin e njerëzve, ndonjë populli, as që ka për qëllim t’i ofrojë të ardhura materiale duke lënë pas dore anën morale-shpirtërore, as t’i ofrojë kënaqësitë e kësaj bote e të lihet pas dore bota tjetër siç predikojnë disa sekte askeike. Të gjitha këto porosi është e pamundshme që të rrjedhin nga një sistem apo filozofi njerëzore, por ka nevojë për diturinë e pakufishme dhe mëshirën e All-llahut, sepse njeriu shikon nga një aspekt, apo disa sish, duke lënë pas dore shumë të tjerë, kurse All-llahu i Gjithëmëshirshëm dhe Fuqplotë, me diturinë dhe mëshirën e Tij përfshin çdo gjë. Ja të shohim se ç’thotë ajeti Kur’anor për këtë:

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë”.⁵⁹

Pra kjo, rini e dashur na tregon më qartë se sheriati Islam ka veçoritë dhe specifikat e vata, siç janë: drejtësia, përtëritja dhe vazhdimësia. Ky është ai ligj i cili vlen përgjithmon, ndriçon botën, civilizimin, jep lumturinë, ngren lart në qiellë dritën e diturisë dhe kulturës, krenarisë, famës, përhershmerisë...

DËSHMITË MBI PËRHERSHMËRINË, VLERËN DHE AKTUALITETIN E SHERIATIT ISLAM

Se ky shariat është përtëritës, i përhershëm, që ua plotëson popujve nevojat në çdo kohë dhe vend, do të na tregojnë këto dëshmi:

Dëshmia se ç’ndodh në praktikë me sistemet dhe ligjet njerëzore; (ndryshimet permanente na dëshmojnë se i vetmi sistem i volitshëm është sheriati sh.p.)

⁵⁹ Kur’ani: Mulk, 14

Dëshmitë e simpoziumeve shkencore ndërkombëtare dhe Dëshmitë e dijetarëve të matur e të përmendur të Perëndimit

Sa i përket dëshmisë aktuale për përhershmerinë dhe kontinuitet e sheriatit, teorinë ligjore me të cilat mburet koha e re, apo filozofitë e ndryshme kushtetutare, të gjitha këtyre Islami ua ka tejkaluar, prej asaj kohe kur kanë filluar të ngriten para 14 shekujve ligjdhënësia dhe jurisprudenca në baza të sheriatit Islam.

Juristi i famshëm Abdul-Kadër Aude, All-llahu e mëshiroftë atë dhe vëllezërit e tij dëshmorë, në parathënien e vëllimit të parë të librit të tij të njohur “Et-teshri el xhinaj fil Islam” ka paraqitur një përmbledhje me teori dhe parime ligjdhënëse legislative të cilat ligjet pozitive i kanë njohur tek në kohën e fundit.

Teoria mbi barazinë në Islam daton prej kohës së shpalljes së Kur’anit i cila qartë ka përcaktuar se assesi nuk ka përparësi personi prej personit, shoqëria prej tjetrës shoqëri, fisi prej fisit, raca ndaj racës, sunduesi nga qytatari i rëndomtë, argument për këtë kemi në ajetin 13 të sures Huxhurat: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete e s’ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)...” Këtë nuk e kanë njohur ligjet “pozitive” deri në fund të shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, dhe e praktikojnë në mënyrë të kufizuar në krahasimin me sheriatin Islam, e cili teorinë e ka shëndrruar krejtësisht në praktikë.

Teorinë mbi liritë njerëzore, Islami e ka praktikuar në formën më të bukur, ku vë në praktikë lirinë e të menduarit, besuarit, të shprehurit etj. Shehidi Abdulkader Aude ka cekur disa tekste të cilat i inicojnë këto liri me të cilat të bindet truri dhe të pushon zemra.

Teoria e të konsultuarit ceket në Kur’an qysh në periudhën Mekkase “...dhe ata që konsultohen në mes veti për punë tëpërbashkëta”⁶⁰ e është përforcuar me ajetin i cili zbriti në Medine:

“E konsultohu me ta në të gjitha çështjet...”⁶¹.

Sheriati Islam ua ka tejkaluar ligjeve të shpikura nga njerëzit, në “parimin e konsultimit” për njëmbëdhjetë shekuj. Revolucioni Francez, ligjit Anglez i cili e ka njohur këtë parim

⁶⁰ Kur’ani: Shura, 38

⁶¹ Kur’ani: Ali Imran, 159

në shek. XVII, kurse ligji i SHBA-ve e ka aprovuar këtë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII.

Poashtu nga këto teori është edhe “Teoria e përkufizimit të kompetencave të sunduesit” e kjo bazohet në tre parime esenciale (qëndrore):

Kufizimi i kompetencave të sunduesit Përgjegjësia për tiraninë dhe gabimet e tij, dhe E drejta e popullit për shkarkimin e tij.

Kjo teori me këto tre parime ka ardhur mu në atë kohë, kur kompetencat e sunduesit në tërë botën ishin absolute mbi popullin; Sheriati Islam është ligji i parë i cili i kufizon këto kompetenca i detyron sunduesit që të sillen në suaza të normave Islame, dhe nuk mund të dalë jashtë këtyre normave, përndryshe nuk duhet të respektohen e as tu dëgjohet fjala.

Teoria e regjistrimit dhe kontratave, është teoria e regjistrimit të borxhit në mënyrë të shkruar qoftë ai i vogël apo i madh. Këto teori i ka përfshirë ajeti 282 i sures Bekare:

“O besimtarë, kur merrni hua prej njeri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga gjiu juaj le të shkruaj një shkruer i drejtë dhe të mos ngurrojë nga të shkruarit është siç e ka mësuar All-llahu...”

Këto teori të shariatit Islam të cilat datojnë qysh para 14-të shekujve gjatë kohë kanë qenë temë dyshimi apo nënçmimi nga armiqtë e shariatit Islam, të cilët me vonë janë detyruar t’i pranojnë për hirë të së vërtetës dhe të penguarit të zullumit ndaj individit dhe shoqërisë.

Shembuj konkret për këtë kemi në dy parime të mirënjohura që vijnë:

Shkurorëzimi të cilin të gjitha shtetet e Perëndimit janë detyruar që ta pranojnë, dhe më i fundit prej tyre ishte shteti katolik Italia. Në vitin 1968 është mbajtur një simpozium në Lahaj për ligjin special shtetëror, i cili ishte i njëmbëdhjeti me radhë, nga temat rreth të cilave u diskutua ishte përgatitja e planit për njohjen e shkurorëzimit dhe ndarjen legale në nivel shtetëror, e kjo do të thotë kthyerje në ligjin Islamik.

Kamata për të cilën një kohë të konsiderueshme kanë menduar se rrota e ekonomike nuk mund të ec përpos me të, derisa erdhi koha ekonomistët më të mëdhenjë në Perëndim e kanë sulmuar dhe gjykuar kamatën në emër të ditorisë (shkencës) dhe

ekonomisë e jo në emër të fesë dhe besimit. Ndodh që emri më i njohur që ceket në këtë sferë është emri i ekonomistit të shquar britanik Kinzi i cili ka konstatuar se “shoqëria nuk mund kurrë të arrijë drejtësinë përveç se me zdukjen e kamatës”. Poashtu gjermani dr. Shaht thotë: “Në mënyrë matematikore del në shesh se e gjith pasuria u kthehet disa kamataxinjëve”.

Duhet që të kthehemi dhe të bëjmë një shikim shkrimeve të dr. Isa Abduhu, dr. Ahmed Nexhar, librit “Ekonomia jonë” të prof. Muhammed Bakir Sadr. temave të ndryshme mbi ekonominë të cilat i ka shkruajtur mendimtari i famshëm Ebul Ala el Mewdudi në të cilat ka sqarime me vlerë të posaçme.

Sa u përket dëshmimeve të simpoziumeve ndërkombëtare mbi përshtatshmërinë dhe përhershëmërinë e sheriatit Islam, mjafton të cekim simpoziumet ndërkombëtare siç vijojnë:

Në vitin 1937 në qytetin Lahaj u mbajt një simpozium për ligjin komparativ, në të u ftua edhe Az’hari sherifi, në këtë tubim morën pjesë dy përfaqësues të tij të cilët folën mbi temën “Përgjegjësia e qytetarit dhe ligji penal në sheriatin Islam”, për pavarësinë e fikhut Islam dhe refuzuan çdo lidhshmëri në mes sheriatit Islam dhe kanunit Romak dhe në fund simpoziumi shënoi përfundime me vlera historike sa i përket njerëzve që mirren me ligjdhënësi, prej referatave perëndimore, në të u regjistruan këto pika:

Konsiderimi e sheriatit Islam si bazë në ligjdhënësinë e përgjithshme Ka gjallëti dhe është gjithmonë aktual

Qëndron nga vetvetiu dhe nuk varet nga diçka tjetër

Në të njejtin qytet, Lahaj, në vitin 1948 u mbajt simpoziumi ndërkombëtar i avokatëve në të cilin morën pjesë 53 shtete nga bota, me përfaqësues më të shquar të tyre në këtë sferë. Ky simpozium përfundoi me këtë konkluzë: “Duke pasur parasysh se ligjdhënësia Islame posedon vlerë dhe rëndësi të posaçme shoqata (lidhja) ndërkombëtare e avokatëve ka nevojë ta studiojë këtë ligjdhënësi dhe duhet stimuluar për këtë çështje”.

Në v. 1950 “Shoqata mbi të drejtat në Lindje” mbajti një simpozium me temën mbi jurisipodencën (fikhun) Islame në fakultetin e drejtësisë pranë Univerzitetit të Parisit në temën “Java e fikhut (jurisipodencës) Islam”. Ishin të ftuar një numër i madh i profesorëve të shquar të fakulteteve juridike të shteteve Arabe si dhe të tjerë nga bota, si të fakulteteve të Ez’harit, avokatë francez, arab dhe orientalistë. Prej fakulteteve, të

Ez'harit kanë marrë pjesë katër profesorë, dy prej Sirie, janë shkoqitur pesë tema të fikhut të cilat i kishin përcaktuar organizata ndërkombëtare një vit më parë. Temat ishin si vijojnë:

Nevoja për pronë private

Nevoja për pronën e përgjithshme (shoqërore) Problematika e të drejtës ndëshkimore (penale) Ndikimi i medhhebeve të ixhtihadit në njëri tjetrin dhe Teoria e kamatës në Islam

Të gjitha ligjëratat ishin në gjuhën frënge dhe për çdo ditë përcaktohej nga një temë. Në fund të temës zhvilloheshin polemika dhe diskutime të rëndësishme me ligjëruesin. Gjatë diskutimeve u ngrit një anëtarë i cili ishte përfaqësues dhe kryetar i lidhjes së avokatëve të Parisit dhe tha: Unë, nuk e di si të gjej përputhshmëri në mes të asaj që është thënë mbi ngurtësinë e fikhut Islam dhe se ai nuk mund të përfshijë nevojat e njeriut të civilizuar dhe në mes të kësaj që tash dëgjojmë në ligjëratat dhe diskutime të cilat vërtetojnë të kundërtën me argumente, parime dhe tekste të argumentuara. Dhe më në fund simpoziumi solli konkluzë-deklarata të përbashkët: “Duke u bazuar në dobishmërinë e padyshimtë se temat të cilat u parashtruan gjatë javës së fikhut Islam dhe diskutimeve që u zhvilluan qartazi konstatojmë se:

Parimet e fikhut kanë vlerë ligjëdhënëse dhe juridike në të cilën nuk dyshohet.

Ndryshimet e mendimeve në fikhun Islam përfshijnë një pasuri të çmuar të kuptimeve dhe njohurive. Kjo është një gjë mahnitëse dhe në këtë mënyrë fikhut Islam i mundësohet t’u përgjigjet çytjeve të kohës.

Këto dëshmi të simpoziumeve ndërkombërate vlejné si argumente për rëndësinë dhe përhershëmërinë e sheriatit Islam.

“Ne do tu bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri sa tu bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton se Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”⁶²

Sa u përket shkenctarëve (të matur) për përhershëmërinë dhe përshtatshmërinë e sheriatit Islam dhe për nevojë që ka bota për të, nuk kanë të numruar. Këto dëshmi nuk vijnë nga dijetarët e Ez’herit, nga shkencëtarët musliman, e as nga profesorët e fikhut

⁶² Kur’ani: Fussilet, 53

nga univerzitetet e mëdha Islamike, por këto janë dëshmi të shkencëtarëve të mëdhenjë të ligjeve pozitive, të cilët jetën e kanë harxhuar duke studijuar ligje të ndryshme, janë bindur për vlerën e tyre, pastaj kur e kanë kuptuar sheriati Islam kanë dëshmuar dhe kanë pranuar sinqerisht se sheriati Islam në çdo periudhë ua ka tejkaluar ligjeve tjera. Pra e shohim të nevojshme që të cekim disa nga dëshmitë e njerëzve të cilët bindshëm flasin për vlerën e tij: Dr. Askio Nesabato, thotë: “Sheriati Islam ua ka tejkaluar në çdo lëmi ligjeve Evropiane, ai është ligj më i sigurt dhe më stabil” Dijetari i shquar Shibril, dekan i fakultetit juridik pranë Univerzitetit të Vijenës në simpoziumin mbi drejtësinë (jurisprudencën) në vitin 1927 ka thënë: “Njerëzia krenohet që Muhammedi i takon racës së tyre, edhe pse nuk dinte shkrim-lexim ka arritur me sukses që para 14 shekujve, ka ardhë me një ligj (shariat) të cilin në Evropianët sikur të arrinin vlerën e tij pas 1000 viteve do të ishim më se të kënaqur”.

Filozofi (anglez) Bernard Shaw thotë: “Feja e cila iu shpall Muhammedit posedon tërheqshmëri të posaçme pasi që ajo ka gjallërinë e përhershme, ajo është feja e vetme e cila i posedon nevojat e kohës, pra jam i mendimit dhe e shoh të nevojshme që Muhammedi të shpallet shpëtimtar i njerëzimit, po sikur udhëheqësia e botës moderne t’i besohet një njeriu si Muhammedi, do t’i zgjidhte të gjitha problemet e kohës aktuale”.

Historiani anglez Veilz në librin e tij “Studime mbi historinë njerëzore” thotë: “Evropa i ka borxh të madh Islamit në aspektin e ligjit administrativ dhe ekonomik”. Historiani Françez Sidijo pohon se ligji i Napoleon Bonapartës është kopjuar nga libri i fikhut të Imam Malikut me titull “Sherh derdir ala metin halil”. Gustav Lebon përcjell fjalët e prof. Libri i cili thotë: “Sikur mos të ishin paraqitur arabët në arenën ndërkombëtare, renesansa evropiane do të vonoheshte për disa shekuj”. Lin Bol në librin e tij “Arabët në Spanjë” thotë: “Kur Evropa ka qenë në errësirën e injorancës dhe prapambeturisë, mu atë kohë (Spanja) Endelusi ishte udhëheqës në dituri dhe simbol i kulturës në botë”.

Të gjitha këto dëshmi dhe të ngjajshme me to, qartazi dëshmojnë për atë se sheriati Islam posedon një thesar juridik, fuqi që e nxit njeriun në shkencë dhe kulturë, vlera e diçkahit shihet kur e pranojnë të tjerët e sidomos armiqtë...

Kanë dëshmuar bota mbi vlerën e tij, madje edhe armiqtë

e vlera qëndron mu aty

kur për dikë (diçka) dëshmojnë armiqtë.

GJENIALITETI I MUSLIMANËVE TË FAMSHËM (DIJETARËVE MUSLIMAN) GJATË HISTORISË

Rini prej asaj që kaloi, përfundojmë se Kur'ani i madhëruar për të cilin brohoritni duhet të jetë udhëzues dhe duhet të sundojë ligji i tij, pra në këtë thirrni njerëz. Kjo është e vetmja rrugë me të cilën arrihet fitorja dhe fama, me të bëheni më të sigurtë dhe stabilizoheni, ... kur populli musliman jetonte sipas parimeve dhe mësimave Islame (në shekujt e kaluar) arriti kulminacionin në sundim dhe famë. Muslimanët kanë mbizotëruar në botë me kulturë dhe shkencë, Evropa ca shekuj është orvatur që të pijë ca pika nga burimi i kulturës Islame, shkencës dhe njehurive të cilat i shpikën muslimanët... derisa arriti kulminacioni në kulturën materiale dhe shkencat natyrore në kohën e re. Rini sikur feja juaj të mos ishte fe e diturisë, sikur Kur'ani të mos ishte prijës i famës, mësimi i fesë suaj simbol i përparimit historia nuk do të dëgjonte e as që do të regjistronte gjenialitetin e stërgjyshërve tuaj, historia nuk do të dëgjonte për prindërit tuaj të shquar anekënd botës të cilët i vunë themelet e kulturës dhe qytetërimit, ia bënë vetes obligimi mësimin, i dhanë botës shkenca dhe njohuri të ndryshme. Meritat e tyre përmenden në Lindje dhe Perëndim shekuj me radhë, me ta krenohen brezat dhe përcjellin lajmet e tyre pandërprerë.

Sa për ilustrim po ua cek disa prej këtyre pishtarë të shkencës dhe diturisë:

Ibn Halduni e ka themeluar sociologjinë, historinë; Ebu Zekerija er-Razi ka qenë pishtar në mjekësi; Ebu Ali ibn Sina në filozofi; Sherif el-Idrisi në gjeografi; Ebu Bekr-Hejthem në matematikë dhe astronomi; Ali ibn Hejthem në fizikë dhe optikë; Ebul-Kasmi Zehravij në kirurgji; Ebu Zekerija el-Avvam në botanikë; Ebul-Bena në aritmetikë; Ebu Rejhan Biruni në historiografi dhe arkeologji; Imam Gazaliu në kritikë dhe mbi të metet psikike; Imam Maliku në fikh, jurisprudencë; Ebu Hanifja në fikh, jurisprudencë; Shafiu në fikh, jurisprudencë; Ahmed ibn Hanbeli në fikh, jurisprudencë... dhe mijëra të tjerë që i hasim në histori. Njëkohësisht shkenctarët dhe orientalistët flasin mbi gjurmët që kanë lënë në shkencë dhe mbi shkrimet e tyre të njohura në botë. Këta pra janë paraardhësit e mi, më gjej të ngjashëm si ata! Rini shpallni botës moton "Kur'ani është kushtetuta jonë" sepse me këtë thirrje ndoshta do të zgjoni popullin nga gjumi, që ta rikthejnë famën e vet të varrosur, e të humbur, shtetin e vet të shkatërruar... kjo për All-llahun nuk është e rëndë që ta bëjë.

“(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqës. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.”⁶³

⁶³ Kur’ani: Haxhxh, 41

XHIHADI ËSHTË RRUGA JONË

A e dini rini ç'do të thotë motoja “Xhiahadi është rruga jonë”?

Ajo do të thotë të japish mundin maksimal dhe të orvatesh me të gjitha forcat që sheriati të funksionojë në praktikë, në sipërfaqen e tokës, të pavërtetat, të cilat janë barrierë në rrugën e thirrjes të zhduken. Duhet të kemi parasysh se xhiahadi në Islam është disa llojesh:

Xhiahadi me pasuri, Xhiahadi predikues, Xhiahadi arsimor, Xhiahadi politik dhe, Xhiahadi luftarak

Për çdo lloj të xhihadit do të sjell sqarime duke shpresuar se do ta kuptoni qëllimin final për të cilin ju jeni krijuar dhe më të cilin , All-llahu juve u ka obliguar.

XHIHADI ME PASURI

Sa i përket Xhihadit me pasuri, ai është bazë për çdo xhihad për të cilin angazhohet i riu (musliman-shënim i përç.) në jetën e tij, pa marrë parasysh a është ai xhiahadi predikues, xhiahadi arsimor, politik apo ai luftarak.

Xhiahadi predikues ka nevojë për pasuri që të ketë bazë materiale për shtypjen dhe distribuimin e librave, gazetave, revistave etj.

Xhiahadi arsimor poashtu ka nevojë për pasuri (që t'i tubojë dhe angazhojë dijetarët dhe njerëzit me famë).

Në sferën e xhihadit politik pasuria është e nevojshme për të gjetur metoda dhe mënyra që të arrihet deri te fuqia dhe për të ofruar njerëz të specializuar në këtë lëmë (politikë).

Xhiahadi luftarak ka nevojë për pasuri, për tu ofruar armë, municion dhe përgatitje tjera ushtarake me të cilat do të mund tu kundërvihet armëve bashëkohore (të kundërshtarëve të Islamit sh.p.)

Xhiahadi me të gjitha llojet e tij nuk ka vlerë nëse si pikënisje nuk e ka xhihadin me pasuri, nëse pasanikët nuk harxhojnë pasuri në rrugën e All-llahut. Për atë shkak All-llahu xh.sh. tregon se shiahadi me pasuri dhe ai i përdorimit të forcës është ngushtë i

lidhur me xhihadin shpirtëror, për të cilin flasin shumë ajete të Kur'anit: "All-llahu bleu nga besimtarët shpirtërat dhe pasurinë e tyre me xhennet"⁶⁴

"Besimtarët janë vetëm ata që i besuan All-llahut, të dërguarit e Tij, e mandje nuk dyshuan dhe për hirë të All-llahut luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre".⁶⁵

"Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hirë të All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj..."⁶⁶

Për këtë dëshmojnë edhe hadithet e Muhammedit a.s. ku thotë: "Kush harxhon në rrugën e All-llahut (prej pasurisë), All-llahu ia paguan atij 700 fish"⁶⁷

"Kush e përgatit një ushtar, edhe ai vetë është ushtar" (nëse nuk ka mundësi që vet të merr pjesë) "Kush kujdeset për familjen e ushtarit, edhe ai është ushtar"

Kur xhihadi me pasuri është bazë për çdo xhihad, ata të cilët janë të caktuar nga muslimanët për punët e xhihadit, duhet ta dinë si ta ruajnë pasurinë, për nevoja ushtarake në të ardhmën. Pra, ju o rini keni përgjegjësi për grumbullimin e mjeteve materiale për realizimin e çështjes së xhihadit, që të arrijë qëllime kulminative të nderit, moralit dhe respektit ndaj fuqisë Islame, jepni atë (pasurinë) me çka u furnizoi All-llahu, ngase vetën fuqia e All-llahut xh.sh. do ta paguajë çdo vepër tuaj të mirë.

XHIHADI PREDIKUES

Xhihadi predikues do të thotë të predikuarit e Islamit në mënyrë gojore, të argumentuarit se thirrja Islame është obligim yni ndaj mosbesimtarëve, ateistëve dhe atyre muslimanëve që kanë devijuar nga rruga e vëretetë. Me këtë lloj xhihadi është i obliguar çdo musliman, sipas mundësive dhe rrethanave...

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Transmetoni prej meje qoftë edhe një ajet". All-llahu xh.sh. në Kur'an ka thënë: "Ata të cilët i kumtojnë shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm Atij e askujt tjetër pos Tij e All-llahut është mjaft llogaritës i mirë".⁶⁸

⁶⁴ Kur'an: Tewbe, 111

⁶⁵ Kur'an: Haxhxh, 15

⁶⁶ Kur'an: Tewbe, 41

⁶⁷ Transmetojnë: Trimidhiu dhe Nesaiu

⁶⁸ Kur'an: Ahzab, 39

Kuptohet që çdo besimtarë është i obliguar që të predikojë këtë fe pët t'ia mundësuar çdo njeriut njohjen e kësaj feje, pa marrë parasysh se a jeton në vendet Islame apo jo.

“Dhe kur All-llahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithsesi t'ua publikoni njerzve, e të mos e fshehni...”.⁶⁹

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga e keqja dhetë besoni All-llahun”.⁷⁰

Duke u nisur nga ajo që cituam më lartë obligohet që të predikojë thirrjen (dawen) në rrethin e tij, mësuesi gjatë shpjegimit, nxënësi në shkollë, nëpunësi dhe punëtori në vendin e punës, tragtari në treg, prindi në familje, gruaja në shtëpi dhe në mesin e motrave të veta. Për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: “Besimtarët dhe besimtare të dashamirë të njërt-tjetrit, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japun zekatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshiroj All-llahut. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë”⁷¹

Rini, gjatë predikimit duhet pasur parasysh këto gjëra:

Të filluarit me atë që është më e rëndësishme, predikimi duhet të fillon prej besimit (akides) para ibadetit, duhet të predikohet ibadeti para rregullave të përgjithshme të jetës, të mësohen gjërat e përgjithshme para imtësirave si dhe, të formuarit e personalitetit para angazhimit me probleme politike. Ky metod i predikimit është metod që e kanë përdorur pejgamberët dhe as'habët e Pejgamberit a.s.

Transmetohet prej Ibni Abbasit se Pejgamberi a.s. e ka dërguar Muadh ibn Xhebelin në Jemen, dhe i ka thënë:

“Ti do të shkosh tek një popull prej Ehli Kitabëve (ithtarët e librit) gjëja e parë në të cilën do t'i thërrasësh të tjerët dihet të jetë shahadeti, dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe se unë jam i dërguari i Tij, nëse ata e pranojnë këtë, lajmëroj se All-llahu i ka obliguar me pesë kohë të namazit, nëse edhe këtë e pranojnë, mësoj se All-llahu i ka obliguar me sadaka e cila merret prej të pasurve dheu jepet të verbërve, nëse edhe këtë e pranojnë, merr prej pasurisë se tyre por jo prej asaj që ata e duan më

⁶⁹ Kur'ani: Ali Imran, 187

⁷⁰ Kur'ani: Ali Imran, 110

⁷¹ Kur'ani: Tewbe, 71

së tepërmi, frikoju mallkimit të të dëmtuarit se në mes tij dhe All-llahut nuk ka perde (lutja e tij nuk refuzohet, sh.p.)⁷²

Muslimi transmeton prej Ibni Mes'udit se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos e thuaj para njerëzve atë që nuk mund ta kuptojnë sepse shkakton huti tek ata”.

Durimi ndaj mundimeve, nga metodat të cilat i përdorin armiqtë e Islamit, në luftën e tyre permanente antiislame është edhe të akuzuarit e predikuesve të tij me akuza dhe intriga të rrejshme, me të vetmin qëllim që atyre t'ua humbin autoritetin para syve të popullit. Predikuesi nuk duhet të humb kohën dhe t'u vë veshin akuzave të cilat bëhen në adresë të tyre por, përkundrazi duhet të ndjek rrugën e Pejgamberit a.s. i cili edhe përskaaj shumë mundimeve, torturave dhe akuzave të pashembullta dhe të pakrahasuara, të tipit se ai është magjistar, poet, i çmendur, gënjeshtar... të gjitha këtyre fyerjeve dhe mundimeve ai nuk u ka dhënë rëndësi, thirrësve të ardhshëm u ka dhënë shembullin më të mirë durimin, bindje dhe qëndrueshmëri, derisa arriti ndihma e Zotit dhe çlirimi (i Mekkes sh.p.).

S'do mend se ligji i All-llahut është që pejgamberët, thirrësit në Islam, gjatë predikimit hasin në lloj-lloj sprovimesh, maltretimesh, persekutimesh “A mos mendojnë njerëzit të thonë: Ne kemi besuar e të mos vihet në sprovë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithsesi do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën, do t'i dallojë edhe gënjeshtarët”.⁷³ “A mendoni se do të hyni ne Xhennet, pa u provuar dhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: Kur do të jetë ndihma e All-llahut?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër!”⁷⁴

Poashtu Kur'ani në tregon fjalët e Llukmanit i cili e këshillon birin e tij: “O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtetë, këto janë nga çështëjet më të preferuara”.⁷⁵

Tirmidhiu, ibn Maxhe, Ibn Habbani, Hakimi, transmetojnë prej Sab ibn Ebi Vekkasit i, cili thotë: “Thamë, o i dërguar i All-llahut, cilët njerëz përjetojnë sprova më të mëdha? Ai (Pejgamberi) tha: “Pejgamberët, njerëzit e mirë; njeriu sprovohet sipas shkallës së besimit, nëse është i bindur në fe sprovohet shumë, nëse në mesimin e tij ka dobësi,

⁷² Transmetohet në: Kutubu Sitte (përveç Malikut)

⁷³ Kur'ani: Ankebut, 2, 3

⁷⁴ Kur'ani: Bekare, 214

⁷⁵ Kur'ani: Llukman, 17

All-llahu e sprovon aq sa e ka besimin. Ai (All-llahu) duke e sprovuar njeriun ia falë mëkatet, ashtu që në sipërfaqen e tokës të ec pa asnjë mëkat”.

Muslimi në librin e tij transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Xhenneti është i rrethuar me mundime kurse Xhehenemi me kënaqësi dhe dëfrime”.

Buhariu poashtu në librin e tij transmeton se kurejshitet i mundonin besimtarët, e ata (besimtarët) erdhën te Pejgamberi a.s i cili ishte i mbuluar me xhumen e tij nën hijen e Qabes, dhe i thanë: “A nuk lyp ndihmë për ne, a nuk i lutesh All-llahut që të ndihmojë? Pejgamberi a.s u përgjigj: “Para jush ka pasur rast kur njeriu është marrë, është futur në tokë, ia kanë vënë sharrën mbi kokë, e kanë ndarë në dy pjesë, me krahër të hekurt ia kanë ndarë mishin prej eshtrave, e as kjo nuk e ka larguar nga feja e tij. Beto hem në All-llahun se kjo fe do të përhapet derisa urdhëri do të udhëtojë prej Sanës deri ne Hadrameut duke mos iu frikuar askujt përpos All-llahut, pra ju mos shpejtoni.”

Rini islame, ju keni për detyrë që në vetvetën tuaj të formoni shprehi durimi, qëndrueshmërie, sakrifikimi, vendosmërie, derisa në fund të korrni fitoren dhe të hyni në Xhennet me pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët... sa shoqëri e mirë është kjo!

STUDIMI I AMBIENTITI DHE RRETHANAVE NË TË CILAT DUHET PREDIKUAR.

Ata të cilët e kanë obligim xhihadin përmes predikimit duhet që ta studijojnë vendin dhe ambientin ku do të predikojnë, të njohin simptomat e dalaletit (humbjes), shkaqet e devijimit, metodën e cila e përkon me aftësitë mendore të tyre, mundësitë, nivelin e njohurive etj. p.sh. në një vend ku sundon komunizmi, ekzistencializimi ose masonizimi, ai popull ka davijuar në ide, besim, moral. Në këtë vend duhet zgjedhur librat të cilat shpërndahen, ligjëratat të cilat mbahen, temat rreth të cilave diskutohet, kurse krejtësisht diametral është rasti në një vend ku mbretëron krishterizmi, idetë kapitaliste, liberalizimi dhe demokracia. S’ka dyshim se me kujdes duhet të studijohen shkaqet e devijimit, poashtu duhet që plotësisht të jihen ata që kanë devijuar. Poashtu ka nevojë për hartimin e planeve dhe gjetjen e metodave përkatëse në kontaktim me të tjerët, e domosdoshme është puna permanente, e palodhshme, që feja të arrin tek të gjithë njerëzit. Fillimi i çdo xhihadi predikues është në qëllimin sa më të shpejtë të përmirësimit të muslimanëve, nashkimit e forcave të tyre.

METODAT E XHIHADIT PREDIKUES

Si metoda të xhihadit predikues janë:

Shpërndarja e literaturës Islame; Shpërndarja e revistave, gazetave Islame;

Hutbeja e xhumasë, ligjërata, derse të përgjithshme nëpër xhamia, shtëpi,

Da'weja (thirrja) në mënyrë individuale, vizitat, ekskursionet, organizimi i kurseve të ndryshme...

Mbajtja e koncerteve (Islamike sh.p.), dramave me tematikë nga historia Islame, me temë shoqërore...

Këto janë disa shembuj mbi xhihadin predikues por problemi nuk përfshihet vetëm në atë që u cek, ka raste kur thirrësi gjen një metodë të përshtatshme për predikimin me të cilën do të ketë shumë sukses, gjë kjo e cila nuk u kujtohet thirrësit tjetër! Me rëndësi është që ata (thirrësit në fe) të shpikin metoda me të cilat do të kenë sukses në popull dhe ta nxisin rininë që të jetojë sipas parimeve Islame, që ata (rinia) të ndejnë përgjegjësi dhe obligim për përhapjen e Islamit. Thirrësit duhet që njerëzve t'u argumentojnë se ata janë predikues të sigurtë të cilët nga rruga e All-llahut nuk i pengon fyerja dhe nënçmimi i dikujt, e as që mund t'i luhasin vështirësitë sadoqë të jenë... as që nuk do t'i luhasin erërat sadoqë të fryejnë, kur janë duke punuar në rrugën e All-llahut, kur ndohmojnë fenë, kur lart ngrejnë fjalën e All-llahut.

XHIHADI ARSIMOR

Sa i përket xhihadit arsimor, kjo do të thotë të japish mundin maksimal për të formuar personalitetet të arsimuar, të kulturuar, me ide të pastërta Islame, me botëkupimie të drejta ndaj fesë Islame, botës, jetës dhe njeriut në përgjithësi.

Për bazë të këtij lloji të xhihadit e kemi hadithin e Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton. Taberaniu prej Bekir ibn Marufit prej Alkames se Pejgamberi a.s. një ditë mbajti një fjalim, lavdëroi punën e një grup muslimanësh, pastaj tha: "Ç'mendojnë ata njerëz të cilët nuk i mësojnë fqinjët e tyre e as që i këshillojnë, as që i urdhërojnë për punë të mira, as që i ndalojnë nga punët e këqija, poashtu ç'mendojnë ata njerëz që nuk mësohen prej fqinjëve të tyre, as që pranojnë këshilla prej tyre. Beto hem se çdo njeri ose do t'i mësoj fqinjët e vet, do t'i këshillojnë, do t'i urdhërojnë në punë të mira, do t'i ndalojnë nga të këqijat, poashtu çdo njeri do të mësohet nga fqinjët e vet, do të këshillohet përndryshe së shpejti do t'ju arrijë denimi" Pejgamberi a.s. zbriti pas kësaj e

njerëzit filluan të pyeten mes vete: “Cilët e ka për qëllim Muhammedi a.s”.?

Pergamberi a.s. tha: “Esharijtë janë njerëz të dijshtëm, në fqinjësi kanë beduin të padijshtëm”. Këtë gjë e morrën vesh Esharijtë, erdhën te Pejgamberi a.s. dhe i thanë: “O i dërguar i All-llahut, ke lavdëruar një popull, kurse neve na ke përmendur për të keq, ç’është halli ynë?”. Pejgamberi a.s. u përgjigj:

“Çdo popull e ka obligim që ta mësoj fqiu e vet, ta këshillojë, ta urdhërojë në të mira, ta ndalojnë nga të këqijat, poashtu çdo popull duket të mësoj nga fqiu i vet, të pranojë këshilla ose do t’u arrijë denimi në këtë botë”. Ata thanë: “ O i dërguar i All-llahut a t’u tregojmë edhe të tjerëve për këtë obligim”? Pejgamberi a.s. përsëriti hadithin. Ata kërkuan një vit afat. Pejgamberi a.s. u dha në vit afat që t’i mësojnë fqinjët e vet dhe pastaj e lexoi këtë ajet të Kur’anit:

“Ata që mohuan të vërtetën nga beni israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe të Isait, të birit të Mejremës. Kështu u nepua, sepse kunëshuan dhe e tepruan. Ata ishin nga ata që nuk ndalonin nëri – tjetrin nga e keqja qëpunonin. E ajo që punonin ishte e shëmtar”⁷⁶

Taberaniu transmeton prej Ibni Abbasit se Pergamberi a.s. ka thënë: “Këshillohuni në mes vete në dituri, se trathtia e moskëshilla është më e rëndë sesa trathtia në pasuri, All-llahu gjithsesi do t’ju pyet për këtë”.

All-llahu xh.sh. në Kur’anin famëlartë thotë:

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për të mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata në mënyrë që ata të kutojnë (e të ruhen)”⁷⁷

Imam Gazaliu në Ihja ulumid – din thotë: “E duhur është që në çdo xhami apo lagje të ketë dijetarë i cili do t’ua mësoj njerëzve fenë, poashtu edhe në fshat duhet të ketë dijetarë, çdo dijetarë duhet të dalë jashtë dhe të komunikojë me njerëzit të cilët i kanë afër, t’ua mësojë fenë dhe dispozitat e sheriatit.

⁷⁶ Kur’ani: Maide, 78, 79

⁷⁷ Kur’ani: Tewbe, 122

Muslimani nuk mund t'ia arrijë qëllimin e xhihadit predikues ashtu siq kërkohet, përderisa të mos pasurohet me dituri nga Kur'ani dhe sunneti, sa më i përgatitur që të jetë aq më tepër do të ketë sukses.

Pasi që çdo besimtar nuk mund ta studijojë në detaje Kur'anin dhe hadithin, atëherë, çdo i ri i cili është predikues duhet të mësojë te dijetarët (ulemaja). Kur të pasurohet me dituri dhe të arrijë kulturë atëherë obligohet që t'i mësojë, udhëzojë, t'i këshillojë njerëzit, sepse ai që nuk ka dituri nuk mund ti mësojë të tjerët.

Për të riun musliman e domosdoshme është që të merr shembull nga historia Islame, biografia e Pejgamberit a.s., praktika e të parëve të mirë të cilët ishin (dhe do të jenë) pasqyrë për muslimanët shekuj më radhë, e domosdoshme është që të shfrytëzojnë praktikën e të parëve të tij të cilën kanë qenë në rrugën e drejtë.

